

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË PËRDORUESVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Autorët

Aliriza Arënlju, Jon Konjufca, Dashmir Bërxulli, Vebi Mujku, Adile Shaqiri

Ky hulumtim është kryer me përkrahjen financiare
të Drejtorisë për Mirëqeniet Sociale në Komunën e Prishtinës.

■ Vlerësimi i nevojave të përdoruesve të shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës

Autorët

Aliriza Arënliu, Jon Konjufca, Dashamir Bërxulli,
Vebi Mujku, Adile Shaqiri

Falenderime:

Tringa Mehmeti koordinatorë e anketuesve.

Anketueset/it:

Ylber Sahitaj, Edita Veseli, Albona Kadriji, Erona Mjekiqi,
Elona Jakupi, Qëndresa Kamberi, Tringa Rama, Violete Imeri,
Nita Konjusha, Valentina Jashanica, Anduene Lahi,
Erblina Vrbovci, Bardhosh Xhela, Lirie Berisha, Shkendije Tahiri,
Shpresa Kushaj, Amra Xhaferi, Albanoi Retkoceri, Erzë Pireva,
Sara Xhema, Uesa Qehaja, Driana Isufi, Liridon Rekaj,
Dorentinë Gashi, Erza Pllana.

Stafit të qendrave për punë sociale në Prishtinë
për ndihmën e tyre në hulumtim.

Studimi është implementuar nga Qendra për Shëndet Global
në bashkëpunim me departamentin e Psikologjisë në
Universitetin e Prishtinës, "Hasan Prishtina".

Ky hulumtim është kryer me përkrahjen financiare të
Drejtorisë për Mirëqeniet Sociale
në Komunën e Prishtinës.

Përmbledhja ekzekutive

Vlerësimi i nevojave është një nga metodat eksploruese për të informuar për problemet aktuale apo prezente në një fushë dhe sipas asaj edhe zhvillimin e shërbimeve apo programeve për të adresuar ato çështje. Vlerësimi i nevojave përfshin përshkrimin e situatës ekzistuese dhe të kuptuarit e asaj se çka duhet të bëhet në të ardhmen. Për këtë qëllim Drejtoria për Mirëqenje Sociale në Komunë e Prishtinës ka ndërmarrë këtë vlerësim për të kuptuar gjendjen dhe eventualisht orientojë programet në drejtim të nevojave të identifikuara me vlerësim.

Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës Korrik 2021 –Janar 2022, hulumtimi është përfunduar nga ekipa e Departamentit të Psikologjisë përmes organizatës Qendra për Shëndet Global dhe financuar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës. Ky raport bën përmbledhjen e të dhënave nga studimi kuantitativ dhe kualitativ nga 1093 intervista me kryefamiljarë, 521 anëtarë të familjeve që janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndonjë shërbimi nga QPS në Prishtinë.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizoj dhe të ofroj një pasqyrim dhe dokumentim të gjendjes së familjeve që janë përfitues të ndihmës sociale në Komunën e Prishtinës dhe të identifikojë nevojat e tyre.

Të dhënat e këtij studimi mund të shërbejnë për të ndërtuar politika apo programe nga niveli lokal për ofruesit e shërbimeve sociale në Prishtinë por gjithashtu mund të ofrohet si model studimi edhe për komunat tjera në Kosovë. Nga informacioni që kemi ne, ky është hulumtimi i parë që bën vlerësimin e nevojave të përfituesve nga skema e ndihmes sociale në vendin tonë. Disa nga të gjeturat kryesore të hulumtim janë:

Kryefamiljarë:

- Përfituesit nga skema e ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale në komunën e Prishtinës sa i përket vendbanimit rural dhe urban kanë një distribuim të ngjashëm me popullatën e përgjithshme të komunës që jetojnë.

- Sipas vlerësimit të anketuesve sa i përket kushteve të jashtme të shtëpisë, shumica dërrmuese e përfituesve jetojnë në shtëpi të vjetëra po në gjendje relativisht të mirë 40.4% (401), 23.2% (230) shtëpi të re dhe në gjendje të mirë.

- Sa i përket shërbimeve shëndetësore 85.5% (849) e të anketuarve janë përgjegjur pozitivisht dhe besojnë se mund të marrin shërbime shëndetësore në rast nevojë ndërsa 12.3% (229) e të anketuarve kanë thënë se nuk besojnë se mund të marrin apo pranojnë shërbime shëndetësore.

- Më shumë se dy e treta e kryefamiljarëve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kanë qenë në një situatë ku nuk kanë mundur të blejnë ilaçet e përshkruara nga mjeku për ndonjërin nga anëtarët e familjes.

- Sëmundjet më të shpeshta të përjetuara nga familjarët raportohen të jenë ftohja dhe gripi dhe diku një e treta e anëtarëve të familjes kanë sëmundje kronike.

- 9.5% të kryefamiljarëve kanë deklaruar se kanë pasur situata kur kanë pasur anëtarë të sëmurë por nuk e kanë vizituar mjekun dhe si arsye më të shpeshtë për këtë kanë se të kenë qenë pamundësia e përballimit të

barrës financiare të kontrolleve dhe ilaçeve që mund të përshkruhen.

- Në pyetjen nëse kanë pasur anëtarë të sëmurë për shkak të urisë apo mungesës së ushqimit si pasojë e varfërisë, deklaratat nga ana e tyre kanë qenë si në vijim: një herë 7.35% (73), disa herë (2-3 herë) 10.6% (105), shumë herë (4 apo më shumë herë) 7.8% (77).

- Gjendja e shëndetit mendor të vetë kryefamiljarëve rezulton të jetë e rënduar, nga matjet më shumë se gjysma e të intervistuarve mund të konsiderohen se kanë distres të lartë psikologjik dhe nevojë për ekzaminim dhe trajtim të mëtutjeshëm eventual.

- Arsyet kryesore për mosvaksinim kanë qenë mungesa e informimit ose përkujtimit për vaksinim, informata se vaksinimi është me pagesë dhe bindjet që nuk janë të nevojshme.

- Në pyetjen për gjendjen shëndetësore të çdo anëtari, kryefamiljarët kanë thënë se 23.3% (816) të anëtarëve kanë gjendjen e keqe apo shumë të keqe.

- Nga ata që nuk vijnë ndonjë formë të edukimit (në çdo nivel) arsye kryesore jepen shkaqet ekonomike dhe pagesat që ndërliken me edukimin.

- Në grup moshën 18 - 28 vjeç vetëm 15.1% (56) janë të përfshirë në studime universitare ndërsa 3.8% (14) kanë diplomuar nga universiteti.

- Shumica dërrmuese 80% (792) raportojnë të pranojnë në mes 101 deri në 300 euro në muaj.

- Vetëm 1.8% (18) të kryefamiljarëve raportuan se ndonjëri nga anëtarët të ketë tentuar për të hapur biznes, ndërsa 61.1% (11) prej të intervistuarve deklaruan se janë detyruar ta mbyllin biznesin se nuk ka shkuar mirë.

- Shumë pak nga familjet e intervistuar kultivojnë pemë 10.2% (101), perime 10.5% (104) apo mirren me ndonjë formë të blegtorisë 1% (10).

- 39% (387) kryefamiljarë kanë raportuar se të kenë huazuar para, dhe shumica kanë huazuar nga miqtë dhe familja 80.5% (312), pasuar nga bankat tregtare 11.6% (45). Huamarrja kryesisht është bërë për shkak të arsyeve familjare 42.9% (166) dhe blerjen e artikujve ushqimor 42.9% (166).

- Shumica e kryefamiljarëve 65% (642) e konsiderojnë se gjendja e tyre ekonomike është krejtësisht e pasigurtë, gjersa 32% e konsiderojnë se e kanë të relativisht të sigurtë gjendjen ekonomike.

- Vetëm 10.5% (104) paguajnë qira gjersa të tjerët jetojnë në shtëpitë e tyre apo në shtëpinë e ndonjë familjari apo të afërmëve të tyre.

- Sa i përket kushteve tjera të banimit: 93.9% (933) kanë kuzhinë në vendbanim, 93.9% (933) kanë tualet në vendbanim, 95.3% (946) kanë banjo në vendbanim dhe 93.5% kanë lidhje me sistemin e ujërave të zeza, 95% kanë dush brenda shtëpisë dhe 98% kanë furnizim me energji elektrike.

- 47.03% (467) kanë deklaruar se kanë borxhe/pagesa të mëdha për furnizimin me ujë, 45.92% (456) kanë borxhe të mëdha për furnizimin me rrymë gjersa vetëm 3.42% (34) kanë borxhe ndaj për ngrrotores së qytetit ose për pagesa telefonike.

Në total janë intervistuar 521 anëtarë të tjerë të familjes pasi janë përfunduar intervistat me kryefamiljarë:

- Anëtarët e familjes janë pyetur nëse do të ishin të interesuar të bëjnë punë vullnetare në komunitet a do ta konsideronin këtë opcion 60.3% (314) kanë thënë po, 32.8% (171) jo dhe 6.9% (36) kanë deklaruar ndoshta.

- Përgjigje të ngjashme janë regjistruar edhe në pyetjen nëse do të ishin të interesuar të ndjekin trajnime profesionale të cilat do të ngrinin mundësitë për punësim në të ardhmen, 64.7% (337) kanë deklaruar po, 31.3% (163) me jo dhe 4% (21) me ndoshta.

- Sa i përket sigurisë në shtëpi, familje, komunitet 88.9% (463) të tyre kanë deklaruar se janë të sigurtë, 5.2% (27) nuk ndihen të sigurtë dhe 5.95% (31) deri diku ndihen të sigurtë.

- Në pyetje nëse janë ngacmuar ata apo anëtarët e tjerë të familjes në shkollë, lagje apo komunitet 92.3% (481) nuk janë ngacmuar, 2.3% (12) kanë tentuar t'i ngacmojnë dhe 5.37 (28) janë ngacmuar.

- Në pyetjen nëse kanë qenë të rrezikuar ata apo ndonjë anëtar i familjes nga grabitja/plaçkitja 93.5% kanë thënë jo, 1.92 (10) kanë thënë se kanë tentuar të i plaçkisnin dhe 4.61 (24) kanë thënë se janë plaçkitur.

- Sa i përket pyetjes për rrezikun për trafikim me qenie njerëzore të tyre apo ndonjë anëtar të familjes 96.2% janë përgjegjur me jo, 3.26% me kanë tentuar dhe 0.6% (3) kanë thënë po.

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që nga themelimi i saj në vitin 2003, është përballur me sfida shumë serioze në vënien e themeleve të një sistemi të mbrojtjes sociale.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, gjithnjë me përpjekjen për të siguruar mirëqenien e qytetarëve të Kosovës e në veçanti të grupeve më të cënuara të popullsisë. [Koncept dokumenti, MPMS 2018].

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që nga themelimi i saj e deri në vitin 2021 ka qenë dhe është përgjegjëse për politikën dhe çështjet rregullative në aspekt të mirëqenies sociale dhe përgjegjëse e gjithmbarshme për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit, ose në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale. Pas krijimit të Qeverisë aktuale, dhe fuzionimit të ministrive, tanimë mbrojtja dhe mirëqenia sociale janë të integruara në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Marrë për bazë nivelin dhe qasjen strategjike në vend, Qeveria e Kosovës në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, ka përcaktuar dhjetë (10)¹ objektiva për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si rritja e punësimit përmes masave aktive të tregut të punës, me fokus vetëpunësimin/ndërmarrësinë si dhe subvencionimin e pagave. Punësimin e një anëtari

për çdo familje që nuk e kanë asnjë të punësuar dhe zvogëlimi i numrit të familjeve në asistencë sociale të kategorisë së dytë përmes angazhimit në masat aktive të tregut të punës. Ofrimin e shërbimeve të aftësimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës, avancimin e kushteve të punës të punëtorëve, luftimin e punësimit informal, garantimin e standardeve minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, konform standardeve ndërkombëtare nëpërmjet avancimit të kornizës ligjore. Fuqizimin e mekanizmave të bashkëpunimit me partneret social, promovimit të dialogut social si dhe ngritja e kapaciteteve për Këshillin Ekonomiko – Social.

Fuqizimin e organizatave jo qeveritare përmes procesit të licencimit dhe sigurimit të një fondi për financimin e projekteve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare (personave të moshuar, personave me aftësi të kufizuar, viktimat të dhunës dhe trafikimit). Zhvillimin e formulës së financimit dhe grantit specifik për financimin e shërbimeve sociale në nivel komunal. Trajtimi dhe rishikimi i skemave të aftësisë së kufizuar, në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar. Reformimin e sistemit pensional në Kosovë duke përfshirë aspektet legjislativ dhe organizative, dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe Sigurimin e të drejtave të kategorive të dala nga lufta me fokus zbatimin e legjislacionit për këto kategori. Pra edhe dy dokumentet Strategjike të Ministrisë domosdoshmërisht kanë qenë në linjë dhe janë hartuar bazuar në dhjetë objektivat e Programit të Qeverisë së Kosovës 2017-2021.

¹ STRATEGJIA SEKTORIALE 2018-2022, Prishtinë, 17 dhjetor 2017
<https://mpms.rks-gov.net/epdm-package/strategjia-sektorale-2018-2022/>

Sa i përket shërbimeve sociale në kuadër të mbrojtjes sociale, shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për kategori të ndryshme të personave në nevojë për mbrojtje sociale, siç përcaktohen në Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

Politikat e mbrojtjes sociale të zhvilluara në vend nga Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale deri më 2021 tani më Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) janë zbatuar nga Qendrat për Punë Sociale (38 gjithsejt, përfshir Komunen e Prishtinës e cila ka 3 njësi në kuadër të QPS). Deri në vitin 2009 kur edhe janë decentralizuar shërbimet sociale në nivelin lokal, menaxhimi i QPS-ve ka qenë shumë më i lehtë. Pas decentralizimit dhe bartjes së kompetencave në nivelin lokal, situata është vështitësuar, sepse Komunitet e ndryshme kanë pas qasje të ndryshme ndaj problemeve sociale, ka pas mungesë raportimesh në nivel lokal, mungesë bartjesh informacioneve përmes sistemit të bazës së të dhënave, laramani në ofrimin të shërbimeve, tejkalim të kompetencave dhe mosrespektim të kriterëve, për çka deëshmohet edhe nga raportet e ndryshme të auditimit të skemes sociale dhe vërejtjeve të shumëta të gjetura nga Ministria. Këto shërbime që nga themelimi i tyre me janë ballafaquar me probleme dhe sfida të ndryshme në ofrimin e shërbimeve sociale.^{2 3}

Shërbimet sociale në Kosovës për orientim kanë dy dokumente kryesore që udhëheqin vizionin dhe reformimin e shërbimeve, Strategjia për Decentralizimin për Shërbime Sociale në Kosovë për 2013-2017 dhe Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022. Dokumenti i parë në përgjithësi përcakton si cilat janë shërbimet që duhet ofruar grupeve të ndryshme në nivelin individual, familjar dhe grupeve të cënueshme që kanë për qëllim uljen e varfërisë, rreziqeve të ndryshme dhe integritet të grupeve të cënueshme në shoqëri. Përpos definimit të llojeve të shërbimeve ky dokument cakton edhe ndarjen e përgjegjësisë të institucioneve dhe akterëve relevant në ofrimin e shërbimeve sociale në Kosovë. Përkundër asaj që ka pasur një avancim të shërbimeve me ligjin 04/L-081 dhe 02/L-17 të shërbimeve sociale dhe familjare ende ekzistojnë paqartësi në përgjegjësinë dhe kompetencat e institucioneve që janë përgjegjëse për shërbime të caktuara përfshirë të atyre në nivelin komunal⁴.

Dokumenti i dytë i Strategjisë Sektoriale 2018-2022 përcakton objektivat që duhet arritur për të arritur një mirëqenie sociale, veçanërisht me ofrimin e shërbimeve për grupet e ndryshme të cënuara në shoqërinë

Kosovare. Ky dokument përpos që synon të rrisë ofrimin e shërbimeve për grupet e cënueshme, synon rritjen cilësisë së shërbimeve përmes intervenimeve specifike në shërbimet sociale dhe familjare. Ky dokument inkurajon ofrimin e shërbimeve nga sektori publik dhe ai jopublik. Për më shumë

Në aspektin ligjor ligji 02/L-17 përcakton rolet dhe detyrat e nivelit qendror gjegjësisht të ministrisë dhe komunave në raport me ofrimin e shërbimeve sociale, ku ceket përgjegjës për ofrimin e shërbimeve sociale është Ministria përkatës.

Për më shumë ligji për nr. 03/L-040 përcakton poashtu cek se komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale: përkuqjesja ndaj fëmijëve, shërbimeve familjare dhe sociale, përkuqjesja për grupe të cënueshme, strehimi familjar, kujdesi ndaj të moshuarve etj. Për më shumë Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur përcakton Qendrën për Punë Sociale (QPS)si autoritet kryesor komunal për ofrimin e shërbimeve sociale dhe ofrimin të shërbimeve sociale të përkuqjesjes që ndërliiden me mbrojtjen e individit, grupit dhe familjen.

Përkundër ligjeve të përmendur sipas Koncept Dokumentit për Shërbimet Sociale dhe Familjare ky decentralizim nuk ka qenë edhe aq i suksesshëm dhe disa nga çështjet e përmendura janë: komunat nuk kanë plane strategjike vetanake për përmirësim të shërbimeve sociale; rritja e financimit të shërbimeve sociale në nivelin komunal varet nga vullneti politik dhe jo nga ndonjë mekanizëm i rregullt financiar; QPS nuk kanë rritur numrin e punëtorëve, ato kanë probleme edhe në zëvendësim të personelit që pensionohet; komunat nuk kanë krijuar marrëdhënie me OJQ-të e ndryshme që ofrojnë shërbime sociale; komunat nuk sigurojnë kapacitete që ofojnë trajnime për stafin e QPS; popullata nuk ka informata për shërbimet që ofrohen në QPS; çështja e pagesës së strehimit familjar ka mbetur e pazgjidhur në shumë komuna pas decentralizimit ku vetem disa Komuna i përkrahin familjet strehuese; nuk ka qartësi në monitorimin e punës së QPS, ka probleme në raportim të dhënave, si dhe shumë sfida tjera që presin zgjidhje.

² <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09743.pdf>

³ KONCEPT DOKUMENTI PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

⁴ KONCEPT DOKUMENTI PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Vlerësimet e mëhershme për shërbimet sociale

Të gjitha vlerësimet që janë bërë janë kryesisht të fokusuar në vlerësimin e punës së ofrimit të shërbimeve nga QPS. Në një raport të Save the Children⁵ në nivelin qendror është MPMS gjegjësisht MFPT që ka përgjegjësinë e monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale në Kosovë. Kjo ministri e ka edhe një njësi të Monitorimit dhe Inspektimit të Shërbimeve Social dhe Familjare.

Kjo njësi i ka të përcaktuar disa detyra të përgjithshme nga ligji Nr. 02/L-17 por sipas raportit të njëjtë mungojnë dispozita specifike për monitorim dhe vlerësim dhe se detyrat dhe përgjegjësitë e stafit që punojnë në këtë njësi nuk janë të artikuluar në formë të qartë, gjë që sipas tyre e pengon progresin e monitorimit dhe vlerësimit në nivelin qendror.

Referuar të njëjtit raport është theksuar se QPS-të kanë një sistem funksional për dokumentim dhe mbledhje të të dhënave për përfituesit e tyre që bëhen në formular të standardizuar të cilët edhe raportojnë në periudha të rregullta në Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Problemi sipas tyre qëndron se stafi i QPS-së dhe DKSHMS kanë qasje të kufizuar në sistemin elektronik dhe nuk ka mekanizma që verifikojnë saktësinë e dhënave të futura në sistem. Për më shumë i gjithë ky grumbullim i të dhënave jo domosdoshmërisht analizohet për të ofruar

orientim dhe/apo për t'u përdorur për përmirësimin e shërbimeve që është një problem pothuajse në të gjitha institucionet publike të vendit tonë.

Në një analizë të vitit 2020 që bën një vlerësim të shërbimeve sociale gjatë pandemisë⁶ konstatohet se procesi i decentralizimit i paraparë me ligj dhe strategji në 7 komunat ku është bërë vlerësimi nuk ka ndodhur ende. Ky raport konstaton se gjendja në shumicën e QPS është vështirësuar edhe më shumë për shkak të situatës me pandeminë COVID-19. Më tutje raporti i njëjtë konstaton se edhe mosaprovimi i draft ligjin për financat publike te nivelit lokal nuk ka mundësuar sistemin e granteve për shërbime sociale.

Në përgjithësi kapacitetet komunale mbesin të dobëta pasi nuk ka vlerësim të mirefilltë të nevojave të përdoruesve dhe grupeve vulnerable që rezulton me mungesë të një planifikimi të mirefilltë financiar. Një problem tjetër i identifikuar në këtë raport janë edhe mungesa e stafit profesional me profil të punonjësve shëndetësor në nivelin e drejtorive komunale për mirëqenje sociale.

Një raport tjetër mbi vlerësimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë nga Banka Botëore në 2022⁷ konstaton se decentralizimi i plotë ende nuk ka ndodhur dhe ka një diskrepancë në mes të asaj se si duhet të tjetër (aspektit ligjor) dhe si është në realitet. I njëjti raport për

⁵ https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/PolicyBrief-ALB_0.pdf

⁶ <https://eurochild.org/uploads/2021/04/Raporti-i-Monitorimit-2021-Eng.pdf>

⁷ <https://documents1.eoridbank.org/curated/en/099255003172230352/pdf/P176230099581a01a099140dad12d38ba14.pdf>

më shumë konstaton se një buxhet i vogël ndahet për shërbime sociale në krahasim më shumë e shpenzuar për transfereve me para. E gjithë kjo shkakton që shërbimet sociale të kenë më shumë rol reaktiv se sa proaktive shembull në parandalimin e varfërisë apo problemeve të tjera. Shumica e shërbimeve sipas këtij raporti inciohen nga organet e drejtësisë dhe policisë.

Në një raport tjetër nga OSBE⁸ që bën vlerësimin e kapacitetve të QPS në Kosovë bën disa konstatime të rëndësishme që konfirmojnë gjetjet në raportet e tjera. Ndër të tjera ky raport konstaton sikurse edhe raportet e tjera se shërbimet sociale dhe familjare nuk priorizohen nga komunat që përcillet edhe me ngecje në zbatim të ligjeve për shkak të mungesës së buxhetit dhe stafit adekuat për ofrim të shërbimeve të specifikuar me ligj. Më shumë se gjysma e QPS në kontekstet ku funksionojnë nuk kanë qasje në shërbime specifike si këshillim për fëmijë me sjellje problematike apo edhe për prindër, mungesa të kujdesit ditur si dhe strehim për fëmijët me aftësi të kufizuar ose fëmijë pa përkujdesje të prindit.

Të gjeturat e Raportit të vlerësimit mbi „POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË, 2017⁹“ tregojnë se politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale zënë vend të konsiderueshëm në dokumentet strategjike dhe programet e qeverive, por zbatueshmëria e tyre është ende në nivel të ulët. Disa nga shkaqet për nivelin e ulët të zbatueshmërisë së masave të ndërlidhura me punësimin dhe mirëqenien sociale kanë të bëjnë me jostabilitetin institucional, ndërrimet e shpeshta në krye të institucioneve vendimmarrëse si pasojë e zgjedhjeve të parakohshme, mungesa e vullnetit politik, mos harmonizimi i aktiviteteve dhe objektivave me ndarjet buxhetore dhe presioni nga grupe të caktuara të shoqërisë

Për më shumë situata me COVID-19 ka rënduar edhe shumë punën e QPS-ve. Në një studim tjetër për ndikimin e pandemisë nga instituti GAP¹⁰ QPS-të edhe pse me kapacitete të reduktuara kanë punuar në distribuimin e Pakos Emergjente Fiskale e cila duket se ka rënduar ofrimin e shërbimeve sociale. I njëjti studim konstaton mungesën e stafit profesional në nivele komunale të DKMS. Qendrat gjatë kesaj periudhe janë të stërngarkuara shembull ceket se një rast kur një punëstor social ka menaxhuar 230 raste që është jashtë çdo standardi. Shembull në muajin maj të vitit 2021 në krahasim me muajin mars 2020 numri i familjeve në asistencë sociale është rritur për 666 familje¹¹.

⁸ https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/alb_analiza_e_nevojave_per_kapacitetet_e_qendrave_per_pune_sociale_ne_kosove_ne_fushen_e_promovimit_dhe_mbrotjes_se_te_drejtave_te_femijeve.pdf

⁹ <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raport-vler%C3%ABsimi-p%C3%ABr-Politikat-e-Pun%C3%ABsimit-dhe-Mir%C3%ABqenies-Sociale-n%C3%AB-Kosov%C3%AB.pdf>

¹⁰ <https://www.institutigap.org/lajme/2691>

¹¹ <https://www.evropaelire.org/a/pandemia-rrit-varferine-/30637218.html>

Prishtina, konteksti socio-ekonomik

Sipas regjistrimit të fundit në Kosovë në vitin 2011 nga 1.739.825¹² banorë në Kosovë 198.897 apo 11.4% të banorëve jetojnë në Prishtinë. Nga 293.070 ekonomi familjare 40.292 apo 13.7% të ekonomive familjare jetojnë në Prishtinë. Sa i përket distribuimit rural 55.000 jetojnë në vise rurale apo 17.6% në 9.700 ekonomi familjare.

Sa i përket koncentrimin të banorëve në viset rurale më shumë se gjysma e tyre jetojnë në Cagallavicë, Kolovicë, Barilevë, Nëntë Jugoviq dhe Prugovc. Ka pasur kontestime të ndryshme të këtij regjistrimi me një anim që popullata në Prishtinë është me e madhe se e raportuar në këtë regjistrim¹³.

Sipas disa vlerësimeve këto të dhëna nuk përputhen me të dhënat për shpenzime energjise së shpenzuar, furnizimit me ujë, regjistrimin e veturave, ku sipas disa vlerësimeve sygjerojnë se në Prishtinë jetojnë 450.000 banorë¹⁴. Pra nëse është i saktë ky konstatim atëherë kjo sjell apo ka sjellur me vite probleme të shumta që mund të ndikojnë në planifikim të shërbimeve dhe ndarje të buxheteve që ndërlidhen me numrin e banorëve. Sipas të njëjtit dokument, projektimet që ndërlidhen me rritjen mesatare të popullatës dhe trendet e migrimit, Prishtina në 2022 do të ketë 622.000 banorë. Një fenomen tjetër që karakterizon qytetet Kosovare përfshirë edhe Prishtinën

është migrimi nga viset rurale që rëndon shërbimet publike, përfshirë edhe ato sociale. Prandaj nëse mirret parrasysh numri i punëtoreve social në Prishtinë për numër të banorëve është shumë me e ultë se sa në vendet e tjera shembull në SHBA ku vlerësohen se janë 183 punëtorë social për 100.000 banorë¹⁵.

Sipas statistikave në Kosovë niveli i papunësisë ishte dikur rreth 25%¹⁶ por me ndikimin e pandemisë është rritur në 27.1%¹⁷. Gjatë pandemisë sipas Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovë (APRK) ka pasur një rritje të punëkërkesve për shkak të masave të miratura nga qeveria¹⁸ dhe beneficioneve për këtë popullatë.

Në këtë studim nga Instituti GAP Prishtina renditet e 11 nga të gjitha komunat me numrin e punëkërkesve që jo domosdoshmërisht paraqet shkallën reale të papunësisë. Pasi është qyteti më i madhe në Kosovë, Prishtina ka shkallë më të lartë të migrimit nga qytete dhe zona të tjera rurale të Kosovës. Shembull në një studim me popullatë të randomizuar në vitin 2022 afër gjysma e popullatës së intervistuar në Prishtinë janë të lindur jashtë Prishtinës¹⁹.

¹² AKS regjistrimi i popullatës

¹³ Musaj, M. (2015). Kosovo 2011 census: Contested census ëithin a contested state. Contemporary Southeastern Europe, 2(2), 84-98. http://www.contemporarysee.org/sites/default/files/papers/musaj_kos_census.pdf

¹⁴ [https://prishtinaonline.com/uploads/prishtina_pzhk_2012-2022_shqip%20\(1\).pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/prishtina_pzhk_2012-2022_shqip%20(1).pdf)

¹⁵ https://cdn.ymaws.com/www.naswca.org/resource/resmgr/imported/opinion_mace_10_13.pdf

¹⁶ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-nees/anketa-e-fuqise-punetore-afp-tm1-2021>

¹⁷ "Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 2020," Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Burimi: <https://bit.ly/3vzsT9g>; "Bruto Produkti Vendor TM3 2020," ASK. Burimi: <https://bit.ly/2PFDS1U>

¹⁸ https://www.institutigap.org/documents/50694_T%C3%AB%20papun%C3%AB%20n%C3%AB%20pandemi.pdf

¹⁹ Studimi Manifesta 2022 i publikuar

Çështjet shëndetësore

Përkundër asaj që ligjërisht në Kosovë sigurimet publike shëndetësore konsiderohen si e drejtë themelore njerëzore që nga 2004 Kosova nuk sigurime publike shëndetësore²⁰. Në 2014 qeveria ka aprovuar ligjin për sigurime shëndetësore me qëllimin për krijimin programit për sigurime shëndetësore ajo ende nuk është jetësuar në 2022. Kjo gjendje vështirëson qasjen për shërbime të caktuara shëndetësore për një pjesë të caktuar të popullatës së Kosovës që jeton në varfëri.

Shërbimet në nivel parësor janë shërbimet që financohen dhe menaxhohen nga niveli komunal në Kosovë. Shërbimet parësore supozohen të jenë pararendës të shërbimeve shëndetësore në Kosovë në mënyrë që të zvogëlojë ngarkesën në shërbimet dytësore dhe tretësore shëndetësore në Kosovë.

Shumë hulumtues dhe zyrtarë pajtohen se kjo nuk është duke u realizuar në masë të dëshiruar pasi ka një dështim në ndryshim të qëndimeve dhe sjelljeve të krijuara nga sistemet e kaluara. Shumë pacientë kërkojnë shërbime specialistike në vend të shërbimeve në nivelin parësor.

Nga shërbimet në nivelin e mjekësisë familjare shembull në komunën e Prishtinës mund të përfitojnë këto shërbime: mbrojtja shëndetësore e fëmijëve, mbrojtja shëndetësore e gruas, mjekësia interne, oftalmologjia, ORL, dermatologji, stomatologji, mjekësia e punës, dispanserit e sëmundjeve të mushkërive, sociolog dhe

shërbime të reumatologjisë. Përpos asaj Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ofron shërbime laboratorike, shërbime radiologjike diagnostifikuese, EKG dhe ultrazë. Nga studimet e mëhershme në Kosovë është gjetur se banorët e viseve rurale, posaçërisht gratë, kanë qasje më të limituar në shërbimet shëndetësore²¹.

Për më shumë i njëjti studim ka konstatuar se përpos qasjes banorët në viset rurale kanë më pak informatë për të drejtat e tyre ligjore për kujdes shëndetësor dhe kanë vlerësojnë më negativisht marrëdhëniet e tyre me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Sa i përket përshtatshmërisë së vendndodhjes së qendrave të mjekësisë familjare 40% të respondentëve në një hulumtim në Prishtinë kanë thënë se është e papërshtatshme për shkak të distancës por kanë qenë të kënaqur me kohëzgjatjen e pritjes për të vizituar mjekun në këto qendra²².

²⁰ <https://borgenproject.org/healthcare-in-kosovo/>

²¹ https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/12/RrGGK_Raporti-per-kujdes-shendetesor_2016.pdf

²² https://www.qkmf-pr.org/repository/docs/kenaqshmeria_2015.pdf

Edukimi

Sikurse shërbimet shëndetësore po ashtu edhe edukimi është obligativ për çdo qytetar të Kosovës. Rreziku më i madh që i kanoset familjeve me të hyra të ulta ekonomike dhe që janë përfitues të shërbimeve sociale përfshirë asistencën sociale është braktisja e shkollës nga fëmijët.

Në një raport të statistikave arsimore në komunën e Prishtinës²³ theksohet se në vitin 2019, 290 fëmijë kanë braktisur shkollat ku 289 prej tyre këtë e kanë bërë pas klasës 9.

Grupet më të rrezikuara nga braktisja e shkollës sipas këtij raporti janë fëmijët e komunitetit RAE, vajzat shtatëzëna apo të martuara, fëmijët që kontribuojnë në ekonominë familjare me punën e tyre dhe fëmijët e trafikuar. Poashtu në këtë raport theksohet se faktorët tjerë që kontribuojnë

në braktisje janë: problemet familjare, ekspozimi ndaj skenave të dhunës në familje dhe gjendja e rëndë ekonomike në familjet e tyre.

Duket se të gjitha këto përshkrime të dhëna përshtaten me profilin e përfituesve të shërbimeve sociale. Kjo situatë për këtë popullatë mendohet të ketë qenë më e rëndë gjatë pandemisë edhe pse ende nuk kemi statistika për nivelin e braktisjes së shkollave nga nxënësit gjatë pandemisë.

Por një gjë është e sigurtë se sikurse e gjithë popullata e nxënësve edhe grupet e marginalizuara janë ballafaquar me humbjen mësimore gjatë pandemisë COVID-19 e cila mund të ketë efekte afatëgjate në të ardhmen e fëmijëve.

Problemet e shëndetit mendor

Për shkak të presioneve të ndryshme sociale dhe ekonomike si papunësia²⁴, problemet financiare²⁵, sëmundjet kronike²⁶, dhuna në familje²⁷, nuk është e rrallë që përdoruesit e shërbimeve sociale të ballafaqohen me një rritje të stresit, ankthit dhe rreziku për depresion.

Për më shumë edhe personat që kanë probleme të shëndetit mendor janë shpesh përfitues të shërbimeve sociale për shkak të pasojave fizike, sociale dhe ekonomike të disa çrregullimeve kronike psikiatrike.

²³ https://prishtinaonline.com/uploads/raport_statistikor_i_nxenesve_te_arritur_per_tre_nivelet_e_arsimit_parauniversitar_per_vitin_shkollor_2018-2019.pdf

²⁴ Paul, K. I., & Moser, K. (2009). Unemployment impairs mental health: Meta-analyses. *Journal of Vocational behavior*, 74(3), 264-282.

²⁵ Kiely, K. M., Leach, L. S., Olesen, S. C., & Butterworth, P. (2015). Hoë financial hardship is associated with the onset of mental health problems over time. *Social psychiatry and psychiatric epidemiology*, 50(6), 909-918.

²⁶ Verhaak, P. F., Heijmans, M. J., Peters, L., & Rijken, M. (2005). Chronic disease and mental disorder. *Social science & medicine*, 60(4), 789-797.

²⁷ Trevillion, K., Oram, S., Feder, G., & Howard, L. M. (2012). Experiences of domestic violence and mental disorders: a systematic review and meta-analysis. *PLoS one*, 7(12), e51740.

Metodologjia

Mostra

Sipas projekt propozimit të dorëzuar janë synuar të intervistohen të gjithë përfituesit e shërbimeve sociale nga QPS përfshirë një anëtarë tjetër të familjes. Përfituesit janë kontaktuar nga intervistuesit përmes telefonit pasi janë marrë numrat e telefonit nga zyrtarët e QPS, pasi që është lënë data dhe ora e intervistimit intervistat janë zhvilluar në shtëpitë e përfituesve.

Në total janë intervistuar 1093 kryefamiljarë nga 1700 familje në total.

Sa i përket përfituesve apo kryefamiljarëve që kanë përfituar nga skema sociale në total janë intervistuar 1093 kryefamiljarë/e. Sa i përket intervistave 78% (775) janë përfunduar në vizitën e parë, 10.7% (106) janë kryer në vizitën e dytë dhe 11.3% (112) në vizitën e tretë. 97.81% (972) prej tyre kanë raportuar se flasin shqip kryesisht në shtëpi, 1.51 (15) flasin gjuhën boshnjake dhe 0.2% (2) në gjuhën turke.

Të dhënat demografike për të gjithë anëtarët e familjeve të intervistuar

Në total në familjet e intervistuarve kanë 474% (1601) meshkuj dhe 52.6% (1776) femra, pak më shumë se gjysma e tyre 54% (1824) janë djali/vajza e kryefamiljarit/es të intervistuar, 17.7% (598) gruaja apo burri i krefamiljarit/es. Nga të gjithë anëtarët 36.51% (1233) janë të martuar, 54.4% (1837) asnjëherë të martuar, 1.3% (44) bashkëjetesë, 2.93% (99) të divorcuar, 3.85% (130) i/e vejë dhe 1% (34) të ndarë. Shumica dërmuese e familjarëve janë të lindur në Kosovë 974% (3288) dhe 2.84% (89) jashtë Kosovës. 98.7% (3333) janë të konfesionit Islam, .3 (9) musliman Shiit, .03% katolik. Sa i përket statusit të punësimit të

papunë janë 50.8% (1717), nxënës/student 32.5% (1099), nuk mund të punojnë për shkak të paftësisë 2.22% (75), në pension 1.66% (56), familje me kohë të plotë përgjegjëse për mirëmbajtjen e shtëpisë 4.3% (144), tjetër 7.1% (238), refuzojnë të përgjigjen 1.1% (36), punojnë në biznes familjar .03% (1), të vetëpunësuar .25 (8).

Pyetëtori

Përpilimi i pyetëtorit ka qenë një proces iterativ ku propozimi i pyetëtorit është bërë nga autori i parë i raportit dhe pastaj është diskutuar me DMS dhe zyrtarët e QPS në dy takime të ndara.

Pyetëtori final ju është dërguar në email dhe pas kometeve të fundit është finalizuar verzioni i përdorur në këtë studim. Forma përfundimtare e pyetëtorit është bërë me një punëtor ku është prezantuar pyetëtori para zyrtarëve të DMS dhe stafit të QPS në Prishtinë. Pyetëtori ka pasur 2 seksione kryesore të cilat më pas janë ndarë në nënseksione.

Pjesa e parë e pyetëtorit dedikuar kryefamiljarit/es është përbërë nga shënimet demografike për të gjithë anëtarët e familjes, pyetjet e tjera kanë qenë të grupuara

për çështjet shëndetësore përfshirë shëndetin mendor, edukative dhe në raport me nevojat e tyre. Pyetëtori është zbatuar në formë elektronike duke përdorur aplikacionin COBO që mundëson plotësimin e pyetësorëve pa lidhje të internetit.

Administrimi i pyetëtorit ka zgjatur mes 20 deri në 40 minuta varësisht nga niveli i edukimit të përfituesve dhe gjendjes së tyre shëndetësore. Intervistuesit më parë janë trajnuar në administrimin e pyetëtorit dhe qasjen që duhet të kenë në kontaktin e parë, gjatë, përfundimit dhe eventualisht pas përfundimit të vlerësimit.

Analiza e dhënave


Shumica e të dhënave të prezantuar në këtë raport janë të dhëna deskriptive që tregojnë në përqindje të gjeturat për pyetjet e parashtruara.

Prezantimi i dhënave

Raporti ka një logjikë lineare ku në fillim do të prezantohen të dhënat deskriptive të raportuara nga kryefamiljarët dhe më pas nga anëtari i dytë i familjes. Për tu pasuar me diskutim dhe rekomandime.

Pyetjet drejtuar Kryefamiljarit/es


Figura 1.
Mjedisi ku jeton familija



Nga figura 1 shumica e përfituesve jetojnë në qytet 74.22% (737), 22.77% (236) në fshat dhe 2% (20) në rajon të pazhvilluar. Krahasuar me të dhënat statistikore për nga numri i familjeve që jetojnë në qytet dhe në fshatra, numri i përfituesve nga skema e ndihmës sociale është rreth 5% më i madh në zonat rurale.

Në figurën 2 anketuesit kanë vlerësuar dukjen e jashtë të shtëpisë së familjes 40.4% (401) shtëpi e vjetër në gjendje relativisht të mirë, 15.1% (150) shtëpi e shkatërruar, 23.16% (230) jetojnë në shtëpi në gjendje të mirë, 18.13% (180) në apartament banesor dhe .81% (8) në akomodim për refugjatë (kamp/ndërtesë e adaptuar).

Figura 2 -
Vlerësimi i jashtëm i shtëpisë së familjes



Shërbimet shëndetësore dhe qasja në shërbime në shëndetësore

Në këtë seksion do të prezantohen të dhënat për deklaratimet e kryefamiljarëve në raport me qasjen në shërbime shëndetësore dhe çështjet shëndetësore të përjetuara nga familjet. Në Figurën 3 në pyetjen për distancën nga qendra e mjekësisë familjare shumica e

tyre 40.2% (399) kanë deklaruar se distanca është 1-3 km, pasuar nga më pak se 1 km 36.66% (364), 3-5 km 14.9% (148), më shumë se 10 km 4.93% (49) dhe 5-10 km 3.32% (33).

Figura 3
Distanca nga Qendra
e Mjekësisë Familjare (ambulanca)




Figura 4 paraqet distancën e përfituesve prej spitalit më të afërt që me këtë rast referenë ka qenë Qendra Klinike Universitare e Prishtinës. Diku 21% (208) përfitues e kanë

më shumë se 10 km larg QKUK, diku rreth 10% (96) më pak se 1 km, 27% (266) 5-10 km, 23.5% (234) 3 deri 5 km dhe 19% (189) 1 deri në 3 km shih Figurën 4.

Figura 4
Afërisa e Spitalit





Figura 5 paraqet distribuimin e përgjigjeve për afërsinë e barnatoreve, 8.5% (85) persona kanë raportuar se barnatoren më të afërt e kanë më shumë se 10 km e që kryesisht janë përfitues nga zonat rurale, 3.45 (34) 5 deri

10 km, 8.9% (88) 3 deri në 5 km, 35.2% (350) 1 deri në 3 km dhe shumica 44% (436) më pak se 1 km.


Figura 5
Afërsia me barnatore



Respondentët janë pyetur nëse ndihen të sigurtë në lidhje me mbrojtjen shëndetësore dhe se a besojnë se do të marrin shërbime nëse ju nevojiten. 85.5% (849) të tyre janë përgjegjur pozitivisht se besojnë së mund të marrin

shërbime shëndetësore në rast nevoje dhe 12.3% (122) kanë thënë jo dhe 2.2% (22) kanë refuzuar të përgjigjen në pyetjen e parashtruar shih Figurën 6.


Figura 6
Ndjenja e sigurisë me mbrojtjen shëndetësore



Më shumë se dy e treta e kyefamiliarëve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kanë qenë në një situatë ku nuk kanë mundur të blejnë ilaçet e përshkruara nga mjeku

për ndonjërin nga anëtarët e familjes, 76% (755) kanë thënë po, ndërsa 23.5% kanë deklaruar se nuk kanë pasur kësi situatë.


Figura 7
Mosmundësia për të blerë
ilaçe në 12 muajt e fundit



Sa i përket pyetjeve më të rënda të përjetuara në 12 muajt e fundit ka pasur një varg përgjigjesh të ndryshme nga kryefamiljarët sëmundja më e shpeshtë e përmendur ka qenë ftofja 24.5% (343), gripi 15.6% (155), COVID-19 6.5%

(64), problemet psikologjike 4% (40), dhimbje në shpinë/gju 3.3% (33), pneumoni 1% (10), lëndime .9% (9), helmime 1 (1) dhe 29.81% (296) të tjera shih figurën 8.

Figura 8
Sëmundjet më të rënda të përjetuara nga
anëtarët e familjes në 12 muajt e fundit



Pyetja pasuese pas asaj cila ka qenë sëmundja më e rëndë e përjetuar nga ndonjë anëtar i familjes, kryefamiljarët janë pyetur nëse ata kanë vizituar mjekun 9.5% (94) prej tyre kanë thënë jo dhe 87.4% (868) kanë thënë po dhe 3.1% (31) kanë refuzuar të përgjigjen. Më tutje përqindja e respondentëve që kanë thënë se nuk kanë shkuar te mjeku janë pyetur për arsyet e

mosshkuarjes tek mjeku 40.4% (38) kanë thënë se nuk mund të përballojnë për të paguar shërbimet mjekësore pasi janë shumë të shtrenjta, pasuar me 28.8% (27) që kanë thënë se kanë pritur të shërohen vetë si arsye e mosshkuarjes dhe përgjigjet e tjera të prezantuar në Figurën 10.

Figura 9

A ka vizituar ndonjë mjek





Figura 10

Arsyet e moshkuarjes tek mjeku



Kryefamiljarët janë pyetur nëse a kanë pasur ndonjë të sëmurë nga familjarët e tyre nga uria sepse nuk kanë pasur mundësi të blejnë ushtrim të mjaftueshëm për ta përgjigjet kanë qenë si në vijim: 70.4% (699) asnjëherë, një

herë 7.35% (73), disa herë [2-3] 10.6% (105), shumë here (4 apo më shumë herë) 7.8% (77) dhe 3.9% (39) refuzojnë të përgjigjen.

Gjendja shëndetësore e të gjithë anëtarëve të familjes vlerësuar nga kryefamiljari

Figura 11 paraqet përqindjen për përshkrimin e gjendjes shëndetësore të gjithë anëtarëve të familjes, shumica 38.4% (1332) kanë thënë se gëzojnë shëndet shumë të mirë, 27.8% (966) të mirë, 9.9% (343) të kënaqshëm, 19.5%

(692) të keqe dhe 3.3% (114) shumë të keq. Kryefamiljart kanë deklaruar se 26.9% (932) anëtarë të familjes kanë sëmundje kronike dhe 9.7% (337) anëtarë kanë qenë të infektuar me COVID-19 (deri nëntor 2021).




Figura 11 paraqet përqindjen për përshkrimin e gjendjes shëndetësore të gjithë anëtarëve të familjes, shumica 38.4% (1332) kanë thënë se gëzojnë shëndet shumë të mirë, 27.8% (966) të mirë, 9.9% (343) të kënaqshëm, 19.5%

(692) të keqe dhe 3.3% (114) shumë të keq. Kryefamiljart kanë deklaruar se 26.9% (932) anëtarë të familjes kanë sëmundje kronike dhe 9.7% (337) anëtarë kanë qenë të infektuar me COVID-19 (deri nëntor 2021).

Vaksinimi

Sa i përket vaksinimit kjo është pyetur për çdo anëtarë mbi moshën 14 vjeçare kryefamiljarët kanë thënë se 85.1% (1848) kanë marrë të gjitha vaksinat, 2.8% kanë thënë se i kanë marrë disa prej tyre, 6% (131) nuk kanë marrë vaksina dhe 6.2% (133) nuk dijnë ose refuzojnë të përgjigjen. Më tutje kryefamiljart që kanë thënë se anëtarët nuk janë të vaksinuar janë pyetur për arsyet e mos vaksinimit: 16.7%

(32) kanë thënë se vaksinimi nuk është i rëndësishëm, 19.4% (37) nuk ka qasje në shërbime, 6.3% (12) nuk janë përkujtuar për obligimin e vaksinimit, 7.9% (15) vaksinimi nuk ka qenë falas, 35% (67) kanë dhënë arsye tjetër që lidhen kryesisht me mungesë të informatës dhe 14.9% (28) kanë refuzuar të përgjigjen.

Edukimi dhe gasja në edukim

Anëtarët në grup moshën 3-22 vjeç

Në total kanë qenë 79.3% (1659) anëtarë të familjes në moshë 3 deri 22 si moshë potenciale për arsimim, nga ky numër në total 26.1% (433) të tyre kanë deklaruar arsye të ndryshme për mosvijim të ndonjë formë të arsimimit të paraqitur në figurën 12.

Nga figura mund të vërehet se aryeja kryesore e mosvijimit të ndonjë forme të edukimi është kostoja e lartë e shkollës/edukimit (pagesa, transporti, libra) familjet në SNS lirohen nga pagesa dhe librat ju jepen falas, transporti është vetëm problem në disa raste 43.65% (189). Ndërsa nga ata që vijnë shumica dërmuese 94.2% (1150) frekutojnë shkolla/institucione publike, 5.2%

(63) shkolla/institucione private, 0.16% (2) shkollë speciale, 0.16% (2) shkollë fetare dhe 0.3% (4) tjetër.

Kryefamiljari është pyetur poashtu për vijimin e rregullt të institucionit edukativ (parashkollor, fillor, mesëm, universitar), 98.5% (952) kanë thënë se shkojnë çdo ditë, mungon më shumë se 4 ditë në muaj .5% (5), mungon një herë në javë .9% (9). Figura 13 paraqet distancën e shkollës apo institucionit edukativ që e ndjek shumica dërmuese e kanë më pak se 1 km 43.3% (418), 1-3 km 33.8% (327), 3 deri 5 km 13.2% (128), 5 deri 10 km 5.6% (54). Shumica e tyre në institucionin edukativ shkojnë në këmbë 71.1% (687) dhe 27.9 (270) me autobus/minibus.

Figura 12
Arsyet e mosvijimit të shkollimit apo edukimit





Figura 13
Distanca e institucionit edukativ që e ndjek anëtarë prej moshës 3 deri 22




Grup moshë 19-28 vjeç

Nga 370 anëtarë të kësaj grup moshe 97% (359) mund të shkruajnë dhe lexojnë dhe 3% (11) nuk mund të shkruajnë dhe lexojnë. Sa i përket edukimit të tyre Figura 14 bën përmbledhjen e edukimit më të lartë të përfunduar,

shumica kanë të përfunduar gjimnazin 26.2% (97), pasuar nga shkolla e mesme e ultë 18.1% (67), shkolla e mesme profesionale 17.6% (65), 15.1% (56) universiteti i papërfunduar dhe vetëm 3.8 (14) persona me universitet të përfunduar. Vetëm 18.9 (70) janë duke ndjekur ndonjë formë të edukimit pas moshës 18 vjeçare.

Figura 14
Edukimi më i lartë i përfunduar për anëtarë të grup moshës 18-29 vjeç



Kultivimi i pemëve/perimeve dhe blegtoaria

4 pyetje të radhës janë vendosur në pyetësor për të parë nëse ka familje që janë duke kultivuar perime, pemë apo mirren me blegëtori përfshirë mbajtje të pulave, për të parë potencialin e subvencionimeve potenciale në këto prodhimtari.

Në pyetjen nëse janë duke kultivuar perime 10.5% (104) kanë deklaruar se janë duke kultivuar, pothuajse e njëjta përqindje ka qenë edhe për fruta 10.2% (101), më pak kanë qenë për qumësht dhe produkte të qumështit 2.55 (25) dhe

1% (10) kanë thënë se prodhojnë prodhime mishi dhe 4% (39) prodhojnë vezë. Të gjitha këto pyetje kanë qenë nëse janë duke kultivuar për përdorim vetanak e jo për shitje.

Pothuajse të gjithë ata që janë deklaruar se janë të përfshirë në ndonjërin prej aktiviteteve të përmendura më sipër jetojnë në viset rurale të Prishtinës.

Të hyrat mujore dhe çështjet financiare

Tabela 1 bën një përmbledhje të disa pyetjeve për çështjet financiare nga tabela mund të vërehet se shumica e familjeve gati 80% (792) kanë deklaruar se në muajin e fundit kanë pranuar në mes 101 deri 300 euro ku 62% (611) kanë thënë se shuma e pranuar ka qenë e njëjtë si muajin e kaluar ndërsa 28% (274) të respondentëve kanë

deklaruar se kanë pranuar më shumë se muajt e kaluar dhe dikur rreth 10% (103) kanë thënë se ka qenë më pak se muajin e kaluar. 19% (191) të kryefamiljarëve kanë thënë se kanë llogari kursimi dhe 12.6% prej tyre kanë thënë se kanë kartë debiti për pagesa dhe 11.8% të tyre kanë bërë transfer bankare gjatë muajit të fundit.

Tabela 1 - Shuma e të ardhurave në muaj dhe shërbimet bankare

Pyetja	Përgjigjet	% (n)
Shuma e të ardhurave (transferimeve) që familja e juaj ka marrë (neto) gjatë muajit të fundit?	501-1000 euro	0.5% (5)
	301 - 500 euro	3.32% (5)
	101 - 300 euro	79.8% (792)
	1 - 100 euro	16.3% (182)
Krahasuar me muajt e vitit të kaluar, të ardhurat/transferimet e marra gjatë muajit të fundit janë	Refuzoj /Nuk e di	.5% (5)
	Njëjtë me muajt e kaluar	61.5% (611)
	Më shumë se muajt e kaluar	27.59% (274)
	Më pak se muajt e kaluar	10.37% (103)
A keni llogari kursimi?	Refuzoj /Nuk e di	1.9% (19)
	Po	19.23% (191)
	Jo	78.85 (783)
A keni kartë debiti/pagese	Refuzoj /Nuk e di	2% (20)
	Po	12.6% (125)
	Jo	85.4% (848)
A keni për transfer bankare në muajin e fundit	Refuzoj /Nuk e di	2% (20)
	Po	11.8% (117)
	Jo	86.2% (856)

Në tabelën 2 janë të përmbledhura informatat në raport me nëse ndonjë anëtar i familjes ka tentuar të hap ndonjë biznes vetëm 1.8% (18) të kryefamiljarëve raportuan se ndonjëri nga anëtarët të ketë tentuar të hapur biznes, nga 18 që janë deklaruar se dikush nga anëtarët ka hapur biznes 72.2% (13) kanë raportuar se biznesi nuk ka

qenë i regjistruar gjersa vetëm 22.2% (4) kanë deklaruar se e kanë regjistruar. Në pyetjen se çka ka ndodhur me biznesin 11.1 (2) kanë thënë se ka mbetur në nivelin fillestar, 61.1% (11) deklaruan se janë detyruar ta mbyllin se nuk ka shkuar mirë, 16.7% (3) refuzojnë të përgjigjen. Figura 15 në mesatare paraqet mesataret e shpenzimeve


në muajin e kaluar nga kryefamiljarët më së shumti familjet harxhojnë në ushqim me mesatare prej 136.9 euro në muaj, pasuar nga pagesat për shërbime shëndetësore 49 euro dhe më së paku oër ngjarje shoqërore 1.3 euro në muaj. Sa i përket shpenzimeve për edukim familjarët janë pyetur se sa kanë shpenzuar për edukim në mesatare

gjatë një viti, përgjigjet kanë variuar nga 0 deri në 10000 euro që ka rezultuar më një mesatare prej 273 euro në vit apo 22.75 euro në muaj. Në total shpenzimet mesatare të një familjeje në asistencë sociale në Prishtinë kanë rezultuar me 307.15 euro për shpenzimet e përmendura më sipër.

Tabela 2 - Hapja e biznesit nga ndonjë familjar

Pyetja	Përgjigjet	% (n)
A ka tentuar ndonjë nga anëtarët e familjes suaj të fillojë biznesin e tij/saj?	Refuzoj /Nuk e di	1.11% (11)
	Po	1.81% (18)
	Jo	97.08% (964)
A është regjistruar/afarizuar ky biznes?	Refuzoj /Nuk e di	5.56% (1)
	Po	22.2% (4)
	Jo	72.2% (13)
Çfarë ka ndodhur me biznesin?	U përkeqësua	5.56 (1)
	Tjetër	5.56 (1)
	Refuzoj/Nuk e di	16.7% (3)
	Nuk shkoj mirë dhe duhej të mbyllej	61.1% (11)
	Mbetur në nivelin fillestar	11.1% (2)


Figura 15



Sa i përket të hyrave mujore nga Figura 16 mund të shohim se më shumti të hyra raportohen nga tranfertat sociale, pasuar nga ndihma prej miqëeve dhe pagat nga

punësimi. Mestarja totale e të hyrave rezulton më një mesatare prej 180.7 si totali i mesatareve të raportuar më poshtë.

Figura 16
Mestarja e të hyrave nga burime të ndryshme të raportuar nga familjarët



Në tabelën e radhës janë të dhënat mbi huazim të mjeteve financiare, 38.9% (387) kryefamiljarë kanë raportuar se të kenë huazuar para, dhe shumica kanë huazuar nga miqtë dhe familja 80.5% (312), pasuar nga bankat tregtare 11.6% (45). Sa i përket qëllimit të huamarrjes me përqindje të njëjtë kanë deklaruar për

arsye familjare (vdekja, martesë, shpenzimet urgjente mjekësore) 42.9% (186), blerja e artikujve ushqimor 42.9% (186), 6.72% (26) për rinovim të shtëpisë, për detaje të tjera shih tabelën 3. Shumica e kryefamiljarëve 64.6% kanë deklaruar se janë krejtësisht të pasigurtë sa i përket sigurisë ekonomike.


Tabela 3 - Huazimi i parave dhe arsyeja e huazimit

Pyetja	Përgjigjet	% (n)
A ka përdorur familja juaj para të huazuara	Refuzoj /Nuk e di	1.31% (13)
	Po	38.9% (387)
	Jo	59.7% (593)
A është regjistruar/afarizuar ky biznes?	Refuzoj /Nuk e di	5.56% (1)
	Po	22.2% (4)
	Jo	72.2% (13)
Nëse ka hazuar, nga ku?	Tjetër	2.84% (11)
	Miqtë dhe familja	80.5% (312)
	Institucioni mikrofinanciar	1.81% (7)
	Huadhënës joformal	3.1% (12)
	Banka tregtare	11.6% (45)
Cili ishte qëllimi i huasë/huamarrjes më të madhe që keni aktualisht?	Tjetër	4.65 (18)
	Rinovimi i shtëpisë	6.72% (26)
	Refuzoj/nuk di	0.52% (2)
	Blerja e artikujve ushqimor	42.9% (166)
	Arsyet familjare (vdekja, martesë, shpenzimet urgjente mjekësore)	42.9% (166)
	Aktivitete që krijojnë të ardhura	2.33% (9)
Si do të përshkruanit gjendjen tuaj ekonomike të shtëpisë në lidhje me sigurinë ekonomike	Siguruar totalit	1.5% (15)
	Relativisht e sigurtë	31.9% (317)
	Refuzoj/nuk e di	1.91% (19)
	Krejtësisht e pasigurtë	64.6% (642)

Kushtet a banimit dhe infrastruktura

Figura 17 paraqet përqindjen e përgjigjeve në lidhje me pronësinë e vendbanimit aktual. 60.5% (601) kanë thënë se pronar i vendbanimit aktual është familja e tyre apo


ndonjë anëtar i të familjes, 17.7% (176) kanë thënë se është e afërmve të tyre, 13.5% (134) pronë e dikujt tjetër dhe 4.83% (48) pronë e komunës apo e shtetit.



Sa i përket pagesës së qirasë 10.5% (104) kanë deklaruar se paguajnë qira dhe 88.62% (880) nuk paguajnë qira dhe .91% (9) refuzojnë të përgjigjen, dhe diku çereku i intervistuarve raportojnë të jenë të shqetësuar se dikush mund t'i dëbon nga vendbanimi aktual ku ata


jetojnë Figura 18. Ata që paguajnë qira kanë raportuar se paguajnë nga 50 deri në 320 euro në muaj me një mesatare prej 130.5 euro në muaj. Mirëpo të dhënat nga studimi nuk përcaktojnë nëse qiraja paguhet nga vetë familja apo nga dikush tjetër.

Figura 18
Niveli i shqetësimit se dikush mund t'i dëbojë nga vendbanimi aktual



Sa i përket furnizimit me ujë 61.13% (607) furnizohen nga sistemi publik, 21.65 (215) furnizim deri në oborr, 13.5%

(135) me tub brenda banesës dhe 1.31 (13) nga ndonjë burim shih Figurën 19.




Sa i përket kushteve tjera të banimit: 93.9% (933) kanë kuzhinë në vendbanim, 93.9% (933) kanë tualet në vendbanim, 95.3% (946) kanë banjo në vendbanim dhe 93.5% kanë lidhje me sistemin e ujërave të zeza, 95% kanë dush brenda shtëpisë dhe 98% kanë furnizim me energji elektrike.

47.03% (467) kanë deklaruar se kanë borxh/pagesa të mëdha për furnizimin me ujë, 45.92% (456) kanë borxhe të mëdha për furnizimin me rrymë gjersa vetë 3.42% (34) kanë borxher për ngrohtore ose për pagesa telefonike.

Në Figurën 20 shumica e kryefamiljarëve kanë thënë se kanë shpenzuar rrymë sikurse edhe muajt e kaluar 74.8% (743), 19% (189) më shumë se muajt e tjerë dhe 6% (60) më

pa se muajt e tjerë. 74.82% (743) kanë deklaruar se kanë borxh/pagesa të mëdha për furnizimin me ujë, 45.92% (456) kanë borxhe të mëdha për furnizimin me rrymë gjersa vetë 3.42% (34) kanë borxher për ngrohtore ose për pagesa telefonike.




Paragjykimet ndaj familjeve

Kryefamiljarët janë pyetur nëse ata apo ndonjë anëtar i familjes së tyre është trajtuar ndryshe në mënyrë që ata janë ndjerë të paragjykuar Figura 21 18.6% (165) kanë

deklaruar po, 1.51 (15) kanë refuzuar të përgjigjen dhe 81.8% kanë thënë se nuk janë paragjykuar.

Figura 21
Paragjykimi nga të tjerët



Qëndrimet ndaj edukimit

Figura 22 dhe 23 paraqesin nivelin e edukimi që kryefamiljarët mendojnë se është i kënaqshëm për djem dhe vajza. Në përgjithësi nga figurat e mëposhtme nuk mund të vërehet ndonjë dallim në aspektin gjinor pasi

për të dy gjinitë përqindjet se universiteti është nivel i kënaqshëm i edukimi është shumë i ngjashëm rreth 75% e që është e ngjashme edhe për shkollimin e mesëm profesional dikur rreth 12%.

Figura 22
Niveli e edukimit që konsiderohet i kënaqshëm për djem





Figura 23
Niveli e edukimit që konsiderohet i kënaqshëm për vajza



Shëndeti mendor

Tabela e mëposhtme bën një përmbledhje të përgjigjeve të kryefamiljarëve në 10 pyetjet që vlerësojnë distresin psikologjik instrument (Pyetësi i Kessler-it për distres psikologjik) që përdoret për të parë nëse individit ka nevojë për vlerësim më të thuktë të shëndetit mendor.

Përqindjet janë shumë të larta për prezencën e simptomave si (tabela 4): të lodhur pa ndonjë arsye të mirë ku 34.7% (345) thojnë shumicën e kohës dhe 25.8% (257) gjatë gjithë kohës; nervozë gjatë gjithë kohës 20% (199) dhe shumicën e kohës 33.4% (338); aq nervoz sa nuk ju ka qetësuar asgjë 17.8% (177) gjatë gjithë kohës dhe 30% (294) shumicën e kohës; pa shpresë 21.5% (214) gjatë gjithë kohës dhe 31.42% shumicën e kohës; të parahatshëm/

në siklet 19.94% (198) gjatë gjithë kohës dhe 32.1% (319) shumicën e kohës; aq të parahatshëm sa që nuk keni mundur të qëndroni në një vend 18.1% (198) gjatë gjithë kohës dhe 32.1% (319) shumicën e kohës; të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar 19.6% (195) gjatë gjithë kohës dhe 30.4% (302) shumicën e kohës; aq të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar sa që asgjë nuk ka mundur t'ju gëzojë 21.9% (217) gjatë gjithë kohës dhe 30% (296) shumicën e kohës; që gjithçka ka qenë e mundimshme 19.2% (191) gjatë gjithë kohës dhe 29.6% shumicën e kohës; të pavlerë/të padoboshëm 18.1% (180) gjatë gjithë kohës dhe 27.8% (276) shumicën e kohës.

Ajo çka mund të vërehet nga tabela është se në të gjitha pyetjet pothuajse gjysma e kryefamiljarëve raportojnë që t'i përjetojnë gjatë gjithë kohës dhe shumicën e kohës, që jep indikacion për prezencë të lartë të distresit psikologjik në mesin e përfituesve të shërbimeve sociale.

Tabela 4 - Pyetësi për distresin psikologjik Kessler - përqindja e përgjigjeve të kryefamiljarëve

	Asnjëherë	Rrallë herë	Kohë pas kohe	Shumicën e kohës	Gjatë gjithë kohës
Të lodhur pa ndonjë arsye të mirë	5.4% (54)	7.1% (71)	26.8% (266)	34.7% (345)	25.8% (257)
Nervozë	6.04% (60)	10% (100)	29.8% (296)	34.4% (338)	20% (199)
Aq nervozë sa nuk ju ka qetësuar asgjë	12.3% (122)	13.2% (131)	27.1% (269)	29.6% (294)	17.8% (177)
Të pashpresë	9.3% (92)	12.6% (125)	25.2% (250)	31.4% (312)	21.5% (214)
Të parahatshëm/në siklet	7.9% (79)	13.2% (131)	26.8% (266)	32.1% (319)	20% (198)
Aq të parahatshëm/në siklet sa që nuk keni mundur të qëndroni në një vend	10.2% (101)	12.7% (126)	25.8% (256)	33.2% (330)	18.1% (180)
Të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar	10.9% (108)	15.4% (153)	23.7% (235)	30.4% (302)	19.6% (195)
Aq të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar sa që asgjë nuk ka mundur t'ju gëzojë	11.6% (115)	14% (139)	22.6% (224)	30% (298)	21.8% (217)
Gjithçka ka qenë e mundimshme	6.7% (69)	16.8% (167)	27.4% (272)	29.6% (294)	19.2% (191)
Të pavlerë/ të padobishëm	12.3% (125)	16.3% (162)	25.2% (250)	27.8% (276)	18.1% (180)


Pyetjet Drejtuar Familjarit

Në total janë intervistuar 521 anëtarë të tjerë të familjes pasi janë përfunduar intervistat me kryefamiljarë. Seksioni i mëposhtëm pasqyron rezultatet nga hulumtimi për këtë grup.

Anëtarët e familjes janë pyetur nëse do të ishin të interesuar të bëjnë punë vullnetarë në komunitet a do ta konsideronin këtë opcion 60.3% (314) kanë thënë po, 32.8% (171) jo dhe 6.9% (36) kanë deklaruar ndoshta.

Përgjigje të ngjashme janë regjistruar edhe në pyetjen nëse do të ishin të interesuar të ndjekin trajnime profesionale të cilat do të ngrinin gjasat e punësimit në të ardhmen, 64.7% (337) kanë deklaruar po, 31.3% (163) me jo dhe 4% (21) me ndoshta shih figurën 24.

Figura 24
Interesimi për të ndjekur trajnime profesionale



Anëtarët e familjes janë pyetur disa pyetje në raport me sigurinë e tyre, ngacmimet, rrezikun për plaçkitje, trafikim etj. Sa i përket sigurisë në shtëpi, familje, komunitet 88.9% (463) të tyre kanë deklaruar se janë të sigurtë, 5.2% (27) nuk ndihen të sigurtë dhe 5.95% (31) deri diku ndihen të sigurtë.

Në pyetje nëse janë ngacmuar ata apo anëtarët e tjerë të familjes në shkollë, lagje apo komunitet 92.3% (481) nuk janë ngacmuar, 2.3% (12) kanë tentuar t'i ngacmojnë dhe 5.37 (28) janë ngacmuar.

Në pyetjen nëse kanë qenë të rrezikuar ata apo ndonjë anëtar i familjes nga grabitja/plaçkitja 93.5% kanë thënë jo, 1.92 (10) kanë thënë se kanë tentuar dhe 4.61 (24) kanë thënë se janë plaçkitur.

Sa i përket rrezikimit të tyre apo ndonjë anërtari tjetër të familjes për tu rrëmbyer me dhunë 98% kanë thënë jo, 1% (5) kanë thënë se kanë tentuar dhe 1% (5) janë përgjegjur

me po. Sa i përket pyetjes për rrezikun për trafikim të vetes apo ndonjë anëtar të familjes 96.2% janë përgjegjur me jo, 3.26% me kanë tentuar dhe 0.6% (3) kanë thënë po.

Anëtarët e tjerë të familjes poashtu kanë plotësuar pyetësorin për matjen e distresit psikologjik dhe tabela e mëposhtme bën një përmbledhje të rezultateve në çdo pyetje të këtij pyetësi.

Nga kjo tabelë sikurse edhe për kryefamiljarin mund të shohim se në shumicë të pyetjeve gjegjësisht simptomave të përmendura më shumë se gjysma e respondentëve kanë raportuar t'i kanë përjetuar shumicën e kohës apo gjatë gjithë kohës.

Tabela 5 - Pyetësi për distresin psikologjik Kessler -
përqindja e përgjigjeve për anëtarin e dytë të intervistuar

	Asnjëherë	Rrallë herë	Kohë pas kohe	Shumicën e kohës	Gjatë gjithë kohës
Të lodhur pa ndonjë arsye të mirë	5.9% (31)	9.4% (49)	22.3% (116)	37% (193)	25.3% (132)
Nervozë	5% (26)	9% (47)	28.9% (151)	33.4% (177)	23% (120)
Aq nervozë sa nuk ju ka qetësuar asgjë	9.8% (51)	15.2% (79)	22.3% (118)	31.9% (166)	20.9% (51)
Të pashpresë	9.2% (48)	11.7% (61)	20.9% (109)	32.6% (170)	25.5% (133)
Të parahatshëm/në siklet	9.4% (49)	13.3% (69)	23.8% (124)	30% (156)	22.5% (122)
Aq të parahatshëm/në siklet sa që nuk keni mundur të qëndroni në një vend	9.8% (51)	11.7% (61)	23.6% (123)	30.9% (161)	23.6% (125)
Të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar	10.4% (54)	14.4% (75)	22.1% (115)	30.7% (160)	22.5% (117)
Aq të të dëshpruar/të pashpresë/të depresionuar sa që asgjë nuk ka mundur t'ju gëzojë	10.9% (57)	11.7% (61)	22.2% (116)	29.4% (153)	25.7% (134)
Gjithçka ka qenë e mundimshme	6.1% (32)	16.9% (88)	27.6% (129)	30.5% (159)	21.7% (113)
Të pavlerë/ të padobishëm	13.4% (70)	13.6% (71)	21.5% (112)	30.1% (157)	21.3% (111)

Të dhënat kualitative

Në proces ne kemi zhvilluar 5 fokus grupe gjatë periudhës shkurt-mars 2022 me përfitues të shërbimeve sociale. Këto diskutime janë ndikuar nga periudha e pandemisë dhe "post-pandemisë".

Shumica e problemeve të paraqitura kanë qenë të ndërlidhur me problemet financiare të cilat kanë pasur implikime në jetën e përditshme përfshirë edukimin e fëmijëve dhe funksionimin e përditshëm.

Nga diskutimet e bëra vërehet se QPS dhe stafi mirren me pjesën e ndihmës direkte sociale dhe pak kohë i mbetet stafit për të punuar në tema apo çështje të tjera zhvillimore për individin apo familjen. Kjo ndodh për shkak sistemit aktual dhe ngarkesës së stafit me punë për asistencë direkte.

Vështirësitë e prindërve në sigurimin e kushteve për edukim - Prindërit kanë raportuar vështirësi në sigurimin e kushteve themelore për vijimin e edukimit posaçërisht gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Masat fillestare të ndërmarra nga qeveria për të parandaluar përhapjen e Covid-19 në mars 2020 përfshinin mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore dhe ofrimin e arsimit përmes mësimin në distancë.

Kjo ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në cilësinë e përgjithshme të arsimit, si dhe qasjen në arsim për disa nxënës, veçanërisht ata që u përkisnin grupeve të caktuara në gjendje të cenueshme, siç janë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, të kthyerit, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat që jetojnë në varfëri për shkak të pozitës së dobët financiare të tyre, duke rezultuar në mungesë të pajisjeve thelbësore të TI-së dhe/ose lidhjes në internet.²⁸

"Maspari te paret sidomos kur s'munësh me ja plotësu vet kushtet po shembull tu t'dhan naj tesh' ta jep tezja e grus, t'nimon najkush, shembull tash te m'simi mu m'msojn' qikat shum' mir' e jom munu me ja plo'tsu tona kushtet po une kompjuter s'kam e qajo m'ka pengu mu me ja plotësu msimin komplet se po duhet jo dofar kopje jo qito, krejt po kushtojn' ato."

"Vallai qika që kqyre sa i kanë qit për inhalim veq dje që ma kan dhan, djali tash o online se I kan dal do t'infektum nshkollë aty qika pi pengon ni dhom na e kem me dal n'korridor ftoft, jo spo ka rrjet."

"Jo ni telefon une e kom t'vogël se skom as llaptop as kompjuter, n'qat telefon po munohet me hi pi kojshive natan se ni zid na ndan po po lun rrjeti se djali për moshën që e ka osht shumë I aftë se msusja mka than tani kur po shkon dikun po sheh po thotë "pse mam na se kena qit shpi tmirë, pse ais hoku vesh ai po han?"

Duke përshkruar si një telefon është përdorur nga disa prej fëmijëve: "Po e kena kry njanin, tani tjetrin u dasht' me mush, tani tjetrin. Qishtu u shku dita krejt tu..."

"Edhe mu qashtu ma ka dhan shkolla ni llaptop edhe ni telefon e kena pas tani her' njani n'telefon her' n'ata."

"Jo, se kan' njeq m'simin se s'kem pas internet, une apet s'kom internet, ndrrohet orari e shpesh ju thom msusës nuk ju kushton kurgjo me ma qu ni mesazh me m'than nesër bire n'1 ora. Shpesh m'kan' mungu f'mia se s'interesohet kërkush, si kushton kurgja 1 mesazh me ta qu me than' ndrrohët orari."

Vështirësitë në pagesën e qirasë

Disa nga pjesëmarrësit kanë deklaruar vështirësitë në pagesën e qirasë.

"Ma s'vshtiri e kom pas për qira ai zotnia as 5 euro kurrë s'mi ka fal, nuk mi ka fal, shpin e kom t'vjetër tu u rrxu, ni dhomë, ni korridor."

²⁸https://www.ohchr.org/sites/default/files/2021-08/2020_kosovo_cso_annual_human_rights_report_AL.pdf

Vështirësitë në pagesën e shërbimeve dhe kostove shëndetësore - disa nga pjesëmarrësit kanë deklaruar se kanë pasur vështirësi në pagesën e shpenzimeve shëndetësore që janë ndërlidhur me problemet shëndetësore e veçanërisht me COVID-19.

"Vështirësia maspari sa i përket gripnav, për shembull ni sirup 12 euro ka ndodh e po du me lidh me pas kon ma shumë qysh pe përmenin kta kovidin, kanë mujt me shku 50 a 60 euro ish desht mi marr dikun borxh."

Ballafaqimi me problemet e shëndetit mendor - Pjesëmarrësit kanë deklaruar se përjetojnë probleme të shëndetit mendor dhe disa prej tyre deklarojnë kërkim të ndihmës profesionale. Po ashtu përtej pasojave të dukshme në shëndetin fizik dhe të drejtën për jetë, pandemia dhe masat që lidhen me të gjithashtu ndikuan negativisht në të drejtën për shëndetin mendor.³⁰

"Une shkoj edhe te mjeki se n'at kohë po kum pas ni problem I thojnë depresion tani nuk disha pisha ksi barna nshpi palidhje, tani ni mjek n ambullant thot duhet me shku npsikiatri tani kom shku npsikiatri tani ni motër aty npsikiatri mu ka gjind me do far barnash qaty nifar terapie tani skom problem veq kur tkom problem shkoj, kshtu që mirë kom kalu me to mirë kaloj."

"Me askend nuk flas. Kërkujt hiq valla veq najher thom ma mirë mos me kon hiq."

"Tash jam me depresion nuk jamë mirë."

Si përgjigje se si ballafaqohen me stresin e përditshëm: "Une personalisht veq me terapi se ndryshe nuk di."

"Qikjo osht' te na që nuk t'bjen n"men që duhet me shku te psikologu mu konsultu me ta, ki qaq shumë ngarkesa tjera sa nuk t'bjen as koh' me menu që t'shkoj."

"Me burr dal najkun me hec te lojat qaty dikun t'socialit."

"Une përveti dal shpesh her' dal aty te parku 1 tetori qaty jom me shpi edhe te qajo n'shpi t'saj që jena ajo ka nevoje me bo llaf edhe ajo e ngrata se osht invalid, qaty me ta e shprehi llafin, e shprehi hajgaren e shprehi mërzinë."

Ndihmat e pranuar gjatë pandemisë - familjet raportojnë të kenë pranuar ndihma nga niveli komunal

dhe Kryqi i Kuq i Kosovës në formë të ushqimit dhe mjeteve higjienike gjatë pandemisë.

"Po kena marr' ushqimore, kena marr' higjien, qka shkon për higjien krejt, ushqimi krejt me vaj e me krejt. Un' jom kon edhe me virus qat'her' veq jom dal me mbrojtse I kom marr', na kan' nimu faleminderit zoti I shpërbleft."

"Po komuna dej n'3-4 her' ka pru."

"Ja nja 2-3 her"

²⁹ https://www.ohchr.org/sites/default/files/2021-08/2020_kosovo_cso_annual_human_rights_report_AL.pdf

³⁰ Po aty;

Vështirësi në sigurimin e ushqimit - edhe pse jo shpeshë është raportuar që disa nga familjet të kenë pasur vështirësi edhe në sigurimin e ushqimit.

"Kqyre djali jem une t'kallxova jom nan' e 7 f'mive, krejt m'kan' nimu me social me Kryq t'kuq me Nan' Terez' edhe gjinja m'kan nimue, falemineres t'gjithve me ka krejt edhe m'kan' nimue sociali, s'kom pas për shembull buk' me hangër për kafjall jom shku ma kan' dhan' 50 cent, 1 euro ma kan' dhan', mi kan' dhan' punëtort e social si qety, si te Qafa, si n'Breg t'Dillit m'kan nimue. Pasha zotin vllau jem une n'virus jom met edhe pa hangër gjith' ditën."

Vështirësitë me mbulimin e shpenzimeve të ilaçeve për probleme kronike shëndetësore - shumë nga pjesëmarrësit kanë raportuar veçanërisht vështirësi në

përballimin me çmimin e lartë të ilaçeve për anëtarë të familjes.

"Valla burri kurr' nuk nalët ku t'gjan lemenk, ku t'gjan hekra, ku t'gjan alumin l duhet veq barnat mos me m'i ndërpre."

"Po. Ai n'pun' nuk osht, ai merret veq me qito hekra qka po munet, vallahi nuk po muj me ja dal barnat mu nuk m'dalin 82 euro jo me pagu muj n'muj qira."

Shpenzimet të shtuara shëndetësore për shakak të pandemisë - familjet kanë raportuar se infektimi me virusin COVID-19 ka rënduar buxhetin me familjarë për

shkak të kostos së lartë të shërbimeve shëndetësore gjegjësisht blerjes së ilaçeve.

"300-euro valla kan' shku. Po m'kan' nimu vllaznia e m'kan' nimu."

Përvoja me stafin e qendrës për punë sociale - në përgjithësi vlerësimet për stafin dhe shërbimet kanë qenë

pozitive por duke mos qenë të kënaqur me spektrin e shërbimeve që mund t'i mbulojnë nevojat e tyre.

"Une po flas për veti sa l përket letrav apo diqka kur është kan n'pytje une kom kalu me ta shum' mir' nuk kom pas kurr' kurrfar' problemi."

"Shum' mir', kur vi me l rregullu dokumentat a diqka s'kom kurrfar' telashe. Ta jep letrën qka t'vyn pi dokumentav, l ki n'rreguoll, ta pranon edhe ta vazhdon librezë, për veti po foli."

"Jo, s'i mbulon, duhet me punu edhe dicka tjetër, une l kom unazat e lujta po apet qashtu smut duhet me dal me punu."

"Sum kan' bo probleme kurr."

"Mu m'kan ndihmu shum' se une e kom pas djalin k'tu kur jom nda me burr' është ni sen që mu m'a ndihmu shum'."

Çështja e banimit më qira si problem i rëndësishëm financiar - disa nga pjesëmarrësit kanë deklaruar se pagesa e qirasë është njëra nga barrat kryesore të familjes e cila në një formë nuk ju lejon përballjen me nevoja të tjera themelore të familjes dhe krijimin e borxheve për pagesa të shpenzime të shtëpisë.

Poashtu pjesëmarrësit kanë raportuar sigurimi i banimit social është shumë e vështirë pasi lista e pritjes është shume e gjatë.

"Për mu banimi osht kryesor se une jom me qira, jom qe 10 vjet e po m'bye tash me pagu edhe ujin, rrymën."

"Une me t'kallxu drejt bërllugun se kena pagu kurr' se kena pas mund'si, rrymën apat po l falenderoj socialin a bërllog edhe uj kurr' s'kena pagu se aty dënim na kan qit se s'kisha mundësi me ble orën e me pagu mjeshttrin me vnu."

" Une për banes me hi n'list edhe kan' than' osht' numri madh edhe kërkesa s'osht kërkun hiq. Nuk kom hi n'list' se s'kom shku me apliku hiq se n'komun osht' dasht' edhe ktu. Meqenëse apat pe ceki na që jena vet duhët me pas pak përparësi e une njoh njer'z që nuk jan' n'skem' sociale hiq e kan' përfitu hiq ma larg se te"

Banimit i mundësuar nga të afërmit - Pjesëmarrësit kanë raportuar që për banim në ndihmë ju kanë dalë familjarët apo të afërmit e tyre.

"Une l kam 2 dhoma gjumit edhe salloni kuzhina, me qira nuk jam se te vllau jem."

Puna vullnetare - Në përgjithësi pjesëmarrësit kanë treguar interesim për punë vullnetare, por ndoshta po që se puna dhe kushtet do të ishin me të qarta atëherë ky interesim mund të rritej.

Të dhënat nga studimi kualitativ janë në përputhje me të dhënat kuantitative për gadishmërinë e një pjese të përfituesve janë të gatshëm për punë praktike.

" Se për shembull disa prind kan' thon që nëse shëndeti ja u lejon kishin pas mundësi me u përfshi n'pun' vullnetare nëse ju sigurohet transporti edhe ni shujt. A ish kon kjo nifar krtieri edhe për juve?"

"Po une me gjith' qef kisha bo pun' vullnetare, une e kam edhe fakultetin e përfundum, kom apliku edhe n'komun."

Lajmërimi për skemat e ndryshme sociale - Lajmërimet për skemat sociale janë raportohen të jenë marrë nga stafi, të afërmit dhe për masat e tjera të ndërlidhura me situatën pandemike nga mediat.

"Prej lajmeve kam kuptu për aplikimin për skemën për COvid."

"Për mu ka apliku njo l njoftshëm se nuk ka ardh edhe dikush m'i pyt (stafin e QPS) se na kishin Nimu."

Qasja në edukim parashkollor - raportohet të jetë e vështirë posaçërisht për përfitues apo banor të viseve rurale por edhe atyre urbane.

Qasja në edukim parashkollor në qytete është e limituar pasi që ka pak që janë të sistemit publik dhe shumica janë private ku ka nevojë për pagesa mujore të cilat familjet nuk mund t'i mbulojnë.

" Jo se une prej Mramorit, atje n'Mramor s'ka kopshte. Bile as parashkollor jo po pak parashkollorin ja kom kry atje."

Konkluzionet dhe diskutimi

Me decentralizimin e shërbimeve sociale në nivelin komunal është shumë e rëndësishme të bëhën analiza të veçanta të përdoruesve të shërbimeve sociale në mënyrë që edhe planifikimi i shërbimeve të bëhet sipas nevojave të identifikuara. Ky studim ofron një fillim në këtë drejtim.

Duhet të theksohet se studimi është zhvilluar në një kontekst kohor shumë specifik pas vitit 2020, ku shërbimet sociale dhe familjare ishin të kufizuara për shkak të masave të marra dhe të vendosura për parandalimin e Covid-19, dhe në vitin 2021 shërbimet sociale u rikthyen dhe u vunë në funksion me burimet dhe kapacitetet që kishin. Duhet theksuar që nevoja për shërbime sociale ka qenë në rritje edhe përgjatë vitit 2021, ndërsa kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale nuk janë shtuar.

Të dhënat nga ky raport na ofrojnë informacione se familjarët që janë në asistencë sociale janë duke u ballafaquar me shumë probleme në të njëjtën kohë që janë të natyrës sociale, ekonomike, edukative dhe shëndetësore.

Nëse bëjmë disa konkluzione për sektorë specifik sa i përket shërbimeve shëndetësore pjesëmarrësit konsiderojnë se shërbimet shëndetësore mirren falas në gjitha rastet në institucionet publike që nënkupton kontrollin nga mjeku por jo edhe marrjen e terapisë

farmaceutike pasi që më shumë se dy e treta e kryefamiljarëve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit kanë qenë në një situatë që nuk kanë mundur t'i blejnë ilaçet e tyre 1/3 e anëtarëve të familjes kanë sëmundje kronike). Kjo e gjetur është e ngjashme me studimet paraprake ku janë gjetur se më shumë se 80% e familjeve në Kosovë janë të detyruar të paguajnë për shërbime shëndetësore nga xhepi i tyre, ku shumica e këtyre pagesave ndërlidhen me barërat dhe kontrollat me pajisje specifike mjekësore në institucione private³¹.

Sa i përket vlerësimit të gjendjes shëndetësore popullata e intervistuar duket të jetë në gjendje jo të mirë shëndetësore pasi 23.3% kanë raportuar të mos kenë gjendje të mirë shëndetësore në krahasim me 11.3% të popullatës së përgjithshme³². Një çështje tjetër e rëndësishme në aspektin shëndetësor është se një përqindje e caktuar e respondentëve kanë raportuar të mos i kenë marrë vaksinat në formë të rregullt dhe kryesisht kjo për shkak të mosinformimit.

Nivelet e mosvaksinimit të raportuar në këtë hulumtim janë dukshëm më të larta edhe pse studimi nuk është fokusuar në vakcina specifike në krahasim shembull me mbulesën e vaksinimit për polio ku në 2019, 96% i fëmijëve janë vaksinuar në Kosovë³³. Poashtu një gjetje e rëndësishme e këtij vlerësimi është se një përqindje e lartë e përfituesve kryefamiljarët dhe

³¹ Arenliu Qosaj, F., Froeschl, G., Berisha, M., Bellaqa, B., & Holle, R. (2018). Catastrophic expenditures and impoverishment due to out-of-pocket health payments in Kosovo. *Cost Effectiveness and Resource Allocation*, 16(1), 1-12.

³² <https://ask.rks-gov.net/media/5564/silc-2018.pdf>

³³ Fontana, S., Buttinelli, G., Fiore, S., Amato, C., Pataracchia, M., Kota, M., ... & Stefanelli, P. (2021). Retrospective Analysis of Six Years of Acute Flaccid Paralysis Surveillance and Polio Vaccine Coverage Reported by Italy, Serbia, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Bulgaria, Kosovo, Albania, North Macedonia, Malta, and Greece. *Vaccines*, 10(1), 44.

anëtarët e intervistuar raportojnë nivele relativisht të larta të distresit psikologjik që mund të jetë indikacion i prezencës së ndonjë çrregullimi më serioz të shëndetit mendor³⁴.

Një përqindje e vogël e familjeve diku rreth 10% kanë deklaruar se janë duke kultivuar pemë apo perime për nevoja të veta. Bujqësia konsiderohet si sektori me më shumti të punësuar në Kosovë dhe kjo mund të jetë një mundësi e mirë, posaçërisht për përfituesit e skemave sociale në viset rurale. Megjithatë një hulumtim më i thuktë për nevojat e tyre në komunën e Prishtinës mund të ofrojë një plan më të saktë në këtë drejtim për të përkrahur familjet që të zhvillojnë të hyra potenciale nga këto aktivitete. E ndërlidhur me këtë gjetje është se një përqindje e vogël e respondentëve kanë raportuar se kanë tentuar të hapin ndonjë biznes 1.8%.

Një ndërlidhje strukturore e QPS me organizatat apo shërbimet që ofrojnë përkrahje në bizneset e reja mund të kontribuojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së këtyre bizneseve të pakëta të cilat sipas respondentëve janë mbyllur për shkak se punët nuk kanë shkuar mirë. Një vlerësim më i përpiktë të aftësive dhe nevojave të përdoruesve të shërbimeve mund të krijojë mundësi për projekte të ndara me shoqërinë civile apo me akterë të tjerë që mund të ndihmojnë zhvillimin e aktiviteteve përfituese për përdorues të shërbimeve sociale duke pasur parasysh edhe limitimet që mund t'i kenë përfituesit potencial.

Problemet financiare në literaturë ndikojnë në shëndetin mendor duke krijuar një rreth vicioz me pasoja afatëgjate për të mbetur në varfëri³⁵. Për shkak të ngarkesës së punëtorëve social me skemat e ndryshme sociale ata kanë shumë pak kohë ose fare pak kohë të mirren më çëshjet apo problemet individuale të përfituesve apo familjarëve të tyre, ata kanë shumë pak hapësirë për ofrim të përkrahjes psikosociale posaçërisht për ata që janë nevojë dhe adoleshentët ku mund të punohet në parandalimin e problemeve të shëndetit mendor apo

identifikimit të hershëm të rasteve të shëndetit mendor me rrezik të lartë të kronicitetit.

Studimet paraprake tregojnë se puna sociale me fokus në shëndet mendor ka efekt pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e përfituesve të shërbimeve sociale³⁶ apo edhe me përdorimin e shërbimeve të shëndetit mendor nga përfituesit e shërbimeve sociale³⁷. Po ashtu në sferën e shëndetit mendor me punësimin e psikologëve shkollor mund të ketë një bashkëpunim më të strukturuar me QPS për përcjelljen e fëmijëve që janë përfitues të shërbimeve sociale apo nëse janë në ndonjë grup të cënueshëm me rrezik të lartë për probleme të shëndetit mendor. Krijimi i agjendave më sistematike të bashkëpunimit në mes psikologëve shkollor, qendrës së shëndetit mendor në komunitet në Prishtinë mund të ndihmojë në ndarjen e barrës së problemeve të shëndetit mendor në mes të familjës, shkollës dhe sistemeve në komunitet gjegjësisht shërbimeve që lidhen me shëndetin mendor³⁸.

Për më shumë punëtorët social punojnë në baza ditore me persona që kanë probleme të ndryshme të shëndetit mendor dhe mund të kenë një rol të rëndësishëm në identifikimin e hershëm të problemeve të shëndetit mendor, të varësive dhe vetëvrasjes³⁹.

Sa i përket shkrimit leximit niveli i mungesës së shkrimit leximit në këtë popullatë (mbi moshën 19) është 3% e krahasueshme me atë në nivel të vendit 3.2%⁴⁰. Sa i përket edukimit një përqindje e vogël e të rriturve deri në moshën 28 kanë edukim universitar të përfunduar (3.8%), kjo është me vogël kur krahasohet me nivelin e përgjithshëm të popullatës⁴¹, ky fakt priorizon çëshjen e punës me anëtarët e rinjë të familjes në plane individuale apo ndihmë në rritjen e shkathtësive për punësim përmes trajnimeve të ndryshme profesionale që ofrohen nga institucionet publike në Kosovë.

Arsye kryesore e mosvijimit të edukimit raportohen të jenë shkaqet ekonomike posaçërisht ato të edukimit parashkollor pasi që shumica e tyre ofrohen në sektorin

³⁴ Andreës, G., & Slade, T. (2001). Interpreting scores on the Kessler psychological distress scale (K10). *Australian and New Zealand journal of public health*, 25(6), 494-497.

³⁵ Funk, M., Dreë, N., & Knapp, M. (2012). Mental health, poverty and development. *Journal of public mental health*.

³⁶ Videka-Sherman, L. (1988). Metaanalysis of research on social work practice in mental health. *Social work*, 33(4), 325-338.

³⁷ Fisher, M., Neëton, C., & Sainsbury, E. (2021). *Mental health social work observed*. Routledge.

³⁸ Brener, N. D., Ëeist, M., Adelman, H., Taylor, L., & Vernon Smiley, M. (2007). Mental health and social services: Results from the school health policies and programs study 2006. *Journal of School Health*, 77(8), 486-499.

³⁹ Kourgiantakis, T., Swwwll, K., McNeil, S., Logan, J., Lee, E., Adamson, K., ... & Kuehl, D. (2019). Social work education and training in mental health, addictions and suicide: a scoping review protocol. *BMJ open*, 9(6), e024659.

⁴⁰ <https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>

⁴¹ Arsimi i lartë

privat dhe familjet nuk kanë mundësi të mbulojnë këto shpenzime.

Më shumë se 1/3 e respondentëve deklarojnë se të kenë marrë mjete financiare hua dhe një përqindje relativisht e lartë e respondentëve raportojnë të kenë borxhe për shpenzimet që ndërlidhen me ujin dhe rrymën. Situata me pagesa të rrymës dhe ujit duket të jetë me e rëndë se në popullatën e përgjithshme ku afër 45% të respondentëve raportojnë të kenë vështirësi në kryerjen e pagesave të nevojshme⁴² edhe pse MFPT për familjet në skemën e ndihmës sociale secilin vit mbulon një sasi të kilovateve për familjet përfutuese nga SNS.

Te dhënat nga QPS Prishtinë tregojnë se gjatë vitit 2021 MFPT ka mbuluar mesatarisht rreth 117 euro për familje brenda vitit. Recesionet ekonomike kanë ndikim tek të gjitha familjet çfarëdo që të jenë të ardhurat e tyre, pasi studimet tregojnë se financat janë pjesë integrale e mirëqenjes individuale dhe familjare. Shembull në SHBA edukimi financiar është sygjeruar të jetë pjesë e kurrikulës së trajnimit të punëtorëve social⁴³, prandaj edhe kombinimi i edukimit financiar me atë psikosocial mund të ofrojë rezultate më të mira në zgjedhjet që familjet mund t'i bëjnë. Edukimi financiar nënkupton njohuri rreth financave personale, të kuptuarit e huazuarit, shpenzimet e tepërta dhe planifikimi i një buxheti familjar që ka qëndrueshmëri dhe bazohet në hyrat që i kanë.

Natyrisht kjo mund të jetë e vështirë për tu konsideruar se është e nevojshme për familjet që nuk kanë të hyra, shembull si në studimin aktual ku më se 40% të atyre që kanë deklaruar se kanë marrë borxh e kanë bërë për të blerë ushqim.

Megjithatë konsiderimi se a ka aftësi themelore klineti

për menaxhim financiar mund të jetë pjesë e vlerësimit të punëtorëve social, por edhe trajnimet të veçanta në këtë fushë për punëtorët social mund të ndihmojë në rritjen e kësaj shkathtësie tek përfutuesit.

Në përgjithësi shërbimi dhe komunikimi me stafin e QPS nga të dhënat kualitative konsiderohet të jetë pozitiv dhe vlerësuar se stafi bën gjithçka që është në kompetencën e tyre.

Përkundër që ky raport nuk është fokusuar në nevojat e stafit një eksplorim i veçantë mund të jenë nevojat e stafit në raport me çështje e idenrifikuar në këtë raport përfshirë nevojat për trajnim dhe zhvillim të mëtutjeshëm profesional. Gjatë vitit 2021, kapacitetet e komunes për menaxhim dhe ofrim të shërbimeve sociale kanë vazhduar të jenë të mangëta sikur në dy vitet paraprake. Mungesa e stafit profesional në shërbime sociale brenda DSHMS është raportuar si vështirësi kyçe në menaxhimin e shërbimeve. Si në komunë/DSHMS dhe QPS kanë nevojë për rritje të numrit të stafit me zyrtar profesionist si në shërbimin social profesional po ashtu edhe në stafin e shërbimit të asistencës sociale si dhe planifikim dhe ngritje të kapaciteteve profesionale në dy shërbimet që të jenë sa më afër qytetarit që bie në nevojë për shërbimet sociale dhe familjare.

⁴² <https://ask.rks-gov.net/media/5564/silc-2018.pdf>

⁴³ <https://scholarworks.lib.csusb.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2332&context=etd>

Rekomandimet

- Reformat financiare dhe politikat farmaceutike duhet të targetojnë lehtësime për grupet më vulnerable të shoqërisë sikurse⁴⁴ përfituesit e shërbimeve sociale në mënyrë që të ulin harxhimet shëndetësore. Këto mund të jenë shpëtuese posaçërisht për familje që kanë të sëmurë kronik e që janë relativisht me numër të madh në këtë kategori të popullatës. Kjo vlen edhe për trajtimet jashtë vendit. (politik)
- Fillimi i zbatimit të sigurimeve shëndetësore do të lehtësonte qasjen dhe furnizimin në barna dhe medikamente për familjet përfutuese nga SNS. (politik)
- Problemet e shëndetit mendor qoftë si rezultat i problemeve ekonomike-sociale apo nëse problemet e shëndetit mendor që kanë shkaktuar degradimin ekonomik dhe social janë të rëndësishme për tu adresuar. Një ndërlidhje më e fuqishme në komunitet në mes të QPS dhe qendrës së shëndetit mendor në komunitet në Prishtinë dhe psikologëve shkollor mund të ndihmojë në adresimin e nevojave të shëndetit mendor. (koordinim dhe bashkëpunim me komunitetin/zhvillim të shërbimeve të reja)
- Poashtu punëtorët social mund të fuqizohen në njohuritë e tyre për shëndet mendor dhe çështjet psikosociale dhe ofrim të këshillimit, intervenimeve në situata emergjente dhe ndihmës së parë psikologjike. (trajnime dhe ngritje të kapaciteteve/politik)
- Vlerësimi i nevojave të familjeve duhet të organizohet me një sistem të integruar të menaxhimit të informatave që do të ndihmonte vlerësimin shumëdimensional në formë elektronike, ku dokumentohen nevojat e anëtarëve, veprimet e planifikuara dhe shënimet për progresin apo monitorimin e veprimeve. (trajnime dhe ngritje të kapaciteteve)
- Një sistem i përmendur më sipër do të mundësonte analizën e nevojave në baza të rregullta, krahasime kohore dhe planifikim më të mirë të shërbimeve. (analiza dhe hulumtime)
- Me rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore eventualisht mund të vijë edhe puna më e strukturuar se tani në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e planeve individuale për përfituesit e skemave sociale. Kjo qasje mund të fillojë edhe me pilot projekte për popullata të veçanta dhe më të cenueshme dhe pastaj të zgjerohet në popullata të tjera. (trajnime dhe ngritje të kapaciteteve/zhvillim të shërbimeve të reja)

⁴⁴ Arenliu Qosaj, F., Froeschl, G., Berisha, M., Bellaqa, B., & Holle, R. (2018). Catastrophic expenditures and impoverishment due to out-of-pocket health payments in Kosovo. *Cost Effectiveness and Resource Allocation*, 16(1), 1-12.

- Nevojat e përdorueseve janë komplekse dhe të shumëfishta të cilat duket se shpesh nuk mund të mbulohen nga shërbimeve publike (shëndetësore dhe edukative) dhe shërbimet sociale duhet t'i gjejnë diku tjetër, shërbimet sociale kanë nevojë për buxhet operative që do të mundësonte kontraktimin e shërbimeve të specializuara që mund të ofrohen nga OJQ të ndryshme. Nevoja për buxhet të shtuar në këtë drejtim është e evidente për komunën e Prishtinës duke marrë parasysh numrin ekzistues dhe të projektuar të popullatës. (politik).

- Shërbimet sociale dhe punëtorët social janë të mbingarkuar me procesimin e skemave të ndryshme sociale dhe kanë shumë pak kohë për të ofruar shërbime sociale që do të fokusoheshin në zhvillimin e individual apo të familjes. Nevojitet numër më i madh i stafit me edukim në fushën e punës sociale për shërbime cilësore që do të ishin orientuar në zhvillim më shumë e më pak në mirëmbajtje sociale. (trajtime dhe ngritje të kapaciteteve/politik)

- Kompletimi i stafit të QPS Prishtinë me psikolog, minimalisht secila njësi ta ketë një psikolog i cili do të merret me trajtimin e rasteve në nevojë. (trajtime dhe ngritje të kapaciteteve)

- Qasja e punës sociale mund të jetë edhe më shumë fokusuar se tani në familje duke identifikuar nevojat e anëtarëve dhe duke përdorur burimet në komunitet për ofrim të shërbimeve si: ndryshim të sjelljes, përkrahje për ushqim, vaksinime dhe shërbime të tjera. Por për këtë qasje QPS në Prishtinë ka nevojë për burime njerëzore shtesë. (trajtime dhe ngritje të kapaciteteve)

- Përkrahjet me subvencione të vogla mund të ndihmojnë familjet që janë duke kultivuar pemë apo perime për nevojat e veta që të risin shkallën e prodhimit për të siguruar të ardhura. Këto subvencione mund të jene relevante posaçërisht pas shtrenjtimit të dukshëm të artikujve ushqimor pas konfliktit në Ukrainë. (zhvillim të shërbimeve të reja)

- Një sistem më rigoroz i përcjelljes së vaksinimit të fëmijëve mund të rrisë nivelin e vaksinimit për këtë popullatë. (zhvillim të shërbimeve të reja)

- Për çështjet të punës në komunitet ka nevojë për një studim më të thuktë për vlerësimin e fushave potenciale ku mund të kontribuojnë dhe punojnë përfituesit e skemave sociale. analiza dhe hulumtime)

- Inkuadrimi i edukimit financiar si pjesë e përkrahjes psikosociale të klientëve nga ana e punëtorëve social mund të ndihmojë në menaxhim më të mirë të financave familjare. (trajtime dhe ngritje të kapaciteteve/zhvillim të shërbimeve të reja)

- Sisteme të subvencionimit të familjeve për edukim parashkollor mund të ndihmojnë në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, duke marrë parasysh efektin pozitiv të edukimit parashkollor në zhvillimin e fëmijëve përfshirë shkollimin dhe shpenzimet e tjera. (zhvillim të shërbimeve të reja)

- Një komunikim i rregullt në mes të shkollave dhe QPS lidhur me sigurimin e frekuencimit të fëmijëve në shkollë që janë përfitues të skemës sociale. (trajtime dhe ngritje të kapaciteteve)

- Zhvillimi i broshurave informuese lidhur me mundësitë e ndjekjes së kurseve të ndryshme në qendrën e aftësimin profesional lidhur me ngritjen e kapaciteteve profesionale, marrjen e ndonjë zanati dhe largimi nga varësia e skemës së ndihmës sociale.

